



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 471/8 prot.

Datë 09/04/2024

V E N D I M
Nr. 364/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09/04/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr. **REF-91765-12-20-2023**, me objekt: “**Rikonstruksioni i godinës së anatomisë**”, me fond limit 80,128,758.52 (tetëdhjetë milion e njëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë presje pesëdhjetë e dy) lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 16.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “LEON KONSTRUKSION” SHPK, “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK, BOE L.T.E CONSTRUCTION SHPK & “Colombo” SHPK.

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr. **REF- 91765-12-20-2023**, me objekt: “**Rikonstruksioni i godinës së anatomisë**”, me fond limit 80,128,758.52 (tetëdhjetë milion e njëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë presje pesëdhjetë e dy)

lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 16.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “INERTI” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr. **REF- 91765-12-20-2023**, me objekt: “**Rikonstruksioni i godines se anatomisë**”, me fond limit 80,128,758.52 (tetëdhjetë milion e njëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë presje pesëdhjetë e dy) lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 16.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik “INERTI” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK me NIPT K01725001F dhe adresë Tiranë, Dibër, Ish Trup., Shk., Skënderbej 3, Tiranë.

Operatori ekonomik “INERTI” SHPK me NIPT (J66926804L), me adresë: L.Sporti, Gramsh.

Operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK me NIPT (L42215009L), me adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, Km.6, Rruga dytësore “Iliria”, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë me adresë Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005 – Tiranë.

Subjekte të interesuara:

“LEON KONSTRUKSION” SHPK me NIPT K71820009I dhe adresë Tiranë, Rruga “Tish Dahia”, Kompleksi Kika 2, Pallati nr.9, Kati 8.

“ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK me NIPT K82230002K dhe me adresë Tiranë, Tepelenë, Gjirokastrë, Rruga “Tepelenë-Progonat”, Vendndodhja Skaranë, ngastra nr.80d, Kod kadastral Gj 3400080d rl,zk 1149.

BOE L.T.E CONSTRUCTION SHPK me NIPT L78006801F dhe me adresë Kashar Tiranë Kashar, KASHAR, Rruga “3 Dëshmorët”, godinë banimi dhe shërbimi 1,2,5,8 dhe 11 kate me 2 kat parkim nëntoke & Colombo SHPK.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.12.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr. **REF- 91765-12-20-2023**, me objekt: **“Rikonstruksioni i godines se anatomisë”**, me fond limit 80,128,758.52 (tetëdhjetë milion e njëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë presje pesëdhjete e dy) lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 16.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

II.2. Në datën 16.01.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 12.02.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “INERTI” SHPK	50,555,121.15	lekë Skualifikuar
2. “LIS KONSTRUKSION” SHPK	51,337,793.00	lekë Skualifikuar
3. “ERGI” SHPK	58,810,007.10	lekë Skualifikuar
4. "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK	58,866,757.65	lekë Skualifikuar
5. “ANTE - GROUP” SHPK	61,166,863.00	lekë Skualifikuar
6. "KEVIN KONSTRUKSION" SHPK	61,673,671.00	lekë Skualifikuar
7. "PEPA GROUP" SHPK	63,146,453.05	lekë Skualifikuar
8. "G&M CONSTRUCTION 07" SHPK & "METEO" SHPK	65,048,131.68	lekë Skualifikuar
9. "SENKA" SHPK	65,732,624.90	lekë Skualifikuar
<u>10. "LTE CONSTRUCTION" SHPK & "COLOMBO" SHPK</u>	<u>66,027,666.30</u>	<u>lekë Kualifikuar</u>
11. "MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE" SHPK & "MALAJ COMPANY" SHPK	66,585,598.42	lekë Skualifikuar
12. "AGRI CONSTRUCTION" SHPK	67,116,858.25	lekë Skualifikuar
<u>13. "LEON KONSTRUKSION" SHPK</u>	<u>69,715,283.59</u>	<u>lekë Kualifikuar</u>
14. "KACDEDJA" SHPK	71,311,414.25	lekë Skualifikuar
15. "DESARET COMPANY" SHPK & "AURORA KONSTRUKSION" SHPK	71,475,919.86	lekë Skualifikuar
<u>16. "ERAL CONSTRUCTION COMPANY" SHPK</u>	<u>71,992,323.95</u>	<u>lekë kualifikuar</u>
17. "2N" SHPK	72,618,090.00	lekë Skualifikuar
18. "IGROUP" SHPK	Pa ofertë ekonomike	Skualifikuar
19. "ZEQILLARI" SHPK	Pa ofertë ekonomike	Skualifikuar

II.4. Në datën 12.02.2024, operatorët ekonomikë “*AGRI CONSTRUCTION*” SHPK, "PEPA GROUP" SHPK dhe “*INERTI*” SHPK, janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tyre, në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

A)- Operatori ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” sh.p.k. me NUIS: K01725001F nuk përmbush kriteret si më poshtë:

1. Për pikën 2.3.6 ku operatorët për të gjitha artikujt/pajisjet e listuara në tabelën pika 2.3.5 e DST, duhet të paraqesin katalogë ose broshura. Në katalog duhet të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër ky operator nuk plotëson specifikimet konkretisht:

Për paisjen Nr. 7 është kërkuar U.P.S. 15 KVA, 3 fazor:

- Operatori ekonomik e ka paraqitur pajisjen UPS IPh+N dhe jo tre fazor siç është kërkuar në specifikimet teknike.

Për paisjen Nr. 9 është kërkuar Grupi i furnizimit me ujë sanitar:

- Mungon specifikimi për enën e zgjerimit 25 litra që nuk është paraqitur fare në katalog.

2. Nuk përmbush kriterin 2.3.6. pasi katalogjet teknike të paraqitura janë në gjuhën anglisht. Në dokumentat e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme, të cilat janë detyrues për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe detyrues për të mos u ndryshuar nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumentave të tenderit, është përcaktuar qartë e saktë që “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”, si edhe gjuha e përdorur është përcaktuar në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika 4.7 “Gjuha Shqipe”, atëherë i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer i noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky gjithpërfshirës që i përket çdo lloj dokumentacioni që do të paraqitet në këtë procedurë prokurimi nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës . Vendimi i KPP Nr. 254/2018.

3. Tek sigurimi i ofertës nuk është caktuar data kur është prerë sigurimi për tu paraqitur në këtë procedurë si dhe nga nis afati 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë i vlefshmërisë.

B)- Operatori ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k. me NUIS: L42215009L nuk përmbush kriteret si më poshtë:

1. Për pikën 2.3.1 /b vlerësimi i përvojës së suksesshme për kontratat e realizuara me ente publike operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor, konkretisht puna është nënkontraktuar e gjitha tek operatori ekonomik “Trema Engineering 2” sh.p.k., i cili më pas ka nënkontraktuar një pjesë të punimeve tek operatori ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k. Nga Autoriteti Kontraktor Ujësjiellësi Kanalizime Kamëz sh.a. nuk ka asnjë miratim lidhur me nënkontraktimin e operatorit ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k. për kryerjen e kësaj pjese të punimeve si dhe në kontratën bazë të nënkontraktimit midis “Trema Engineering 2” sh.p.k. dhe “STRABAG AG” nuk ka asnjë pikë lidhur me lejimin e nënkontraktimit.

- Nuk është paraqitur akti i kolaudimit, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” ku citohet se: “Të gjitha

objektet epërkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik...” ku në nenin 3 specifikohet: “Në kuptim të këtij ligji, nëse nuk përcaktohet ndryshe punime ndërtimi quhen të gjitha punimet e ndërtimit për ndërtesat, objektet qytetare, veprat industriale, të infrastrukturës dhe për objektet e tjera.”

C)- Operatori ekonomik “INERTI” sh.p.k. me NUIS: J66926804L nuk përmbush kriteret si më poshtë:

1. Për pikën 2.3.6 ku operatorët për të gjitha artikujt/pajisjet e listuara në tabelën pika 2.3.5 e DST, duhet të paraqesin katalogë ose broshura. Në katalog duhet të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër ky operator nuk plotëson specifikimet konkretisht:

Për pajisjen Nr. 4 Kamera të Brendshme

Operatori Ekonomik ka paraqitur DH IPCHF2541-Z IZ SENSE në fq 41-48. Kjo kamera ka kryesisht përdorim të jashtëm dhe jo të brëndshëm, shprehur kjo në katalogun e produktit, por që bie në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Nuk plotësohet specifikimi teknik:

- IR Dome kamera
- DDR

Për pajisjen Nr. 5 Kamera të Jashtme

Operatori Ekonomik ka paraqitur DH IP-HD2441TM-S IZ SENSE në fq 35-47.

Nuk plotësohet specifikimi teknik:

- IR Bullet kamera
- VF Lens 2,8–12 mm
- DDR

Për pajisjen Nr. 5 Gjenerator Diesel

Në katalogun e paraqitur nuk specifikohet modeli i caktuar dhe kjo pajisje nuk plotëson pikën 2.3.6 të DST-së. Janë paraqitur disa modele që nuk i përkasin firmës që ka deklaruar si prodhuese. Firma e deklaruar është kompani Shqiptare e cila mund ti tregëtojë këto pajisje. Nuk është paraqitur katalogu origjinal i prodhuesit.

Për pajisjen Nr. 8 është kërkuar Grupi MNZ:

- Tek kjo pajisje janë paraqitur vetëm specifikimet për pompat por pa specifikuar mënyrën e vendosjes apo pozicionimin që zënë këto pompa në Grupin MNZ. Meqënëse në katalog janë paraqitur elementët veç e veç këtu mungojnë element të Grupit MNZ si Paneli Komandimit dhe presostate për secilën pompë; si dhe Enët e zgjerimit;
- Mungon Enë zgjerimi 24 litra për pompën pilot;
- Mungon Xhunto antivibrant;

- Mungon Valvola flutur DN50;
- Mungon Kolektori dërgimit;
- Mungon Valvola mos-kthimit DN50 është paraqitur DN40;
- Është e paqartë mënyra si do të lidhen këto dy pompa, pasi dhe valvulat i kanë në dimensione të ndryshme. Pompa cetrifugale ka një valvul më të madhe se pompa vertikale, e cila mund të çojë në shpërthimin e pompës vertikale për shkak të prurjes më të madhe se ajo vertikale.

Për pajisjen Nr. 9 është kërkuar Grupi i furnizimit me ujë sanitar:

Tek kjo paisje janë paraqitur në katalog specifikimet për pompën e ujit ku nuk plotësohet specifikimi teknik për:

- Për pompën SD90 në tabelë janë 4 tipe dhe nuk është markuar modeli të cilit i referohet operatori;
- Mungojnë lidhjet 2” e cila konvertohet me 63mm nuk plotësohet ky specifikim;
- Mungon specifikimi për enën e zgjerimit 25 litra që nuk është paraqitur fare në katalog;
- Nuk plotëson kapacitetin 400V pasi operatori ekonomik e ka paraqitur 220V – 380V.

Për pajisjen Nr. 12 dhe Nr. 13

Tek këto pajisje nuk përcaktohet se cili model UTH3 është sipas katalogut të paraqitur dhe cili model UTH4 është sipas katalogut. Tipi i pajisjes nuk është i markuar si model dhe është e vështirë të kuptohen specifikimet.

Për pajisjen Nr. 16 Nuk plotëson specifikimet teknike:

- Kapaciteti në ftohje/ngrohje 5.00/5.50 k.

2. Katalogjet teknike janë paraqitur anglisht dhe të përkthyer në shqip por mungon firma dhe vula në çdo faqe e përkthyesit. Në faqen e fundit të vërtetimit të përkthimit me nr. 130 rep dhe nr. 131 rep, datë 12/01/2024 citohet: “Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili/a më deklaroi se përkthehu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur “deklaratë noteriale”, nga gjuha Anglisht në gjuhën Shqip dhe e nënshkroi rregullisht para meje noterit”. Nga vërtetimi i përkthimit dokumentacioni nuk është deklaruar noteriale por katalogje si dhe nuk është e nënshkruar nga përkthyesi, në kundërshtim me nenin 135 të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, ku citohet se: “Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes të përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përmbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi”.

II.5. Në datën 22.02.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 11 datë 26.02.2024.

II.6. Në datën 27.02.2024 është administruar dorazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ankesa me nr. 471/2024 prot., datë 27.02.2024 e operatorit ekonomik “**AGRI CONSTRUCTION**” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit sqarojmë:

Në specifikime teknike të dhëna së bashku me projektin teknik janë dhënë edhe specifikimet teknike të UPS si më poshtë:

“5 Sistemi i UPS Projekti ka parashikuar një mbulim të furnizimit me energji të rrjetit nëpërmjet UPS të cilët do të përfshijnë të gjithë konsumatorët preferencialë siç janë pajisje me qarqe elektronike të cilat kërkojnë të mos iu ndërpritet energjia elektrike, si, sistemet e sigurisë, etj, ashtu edhe rrjetit kompjuterik të të gjithë ambjenteve. Në këtë impiant do të furnizohen me energji sistemet e sigurisë, ndriçimit emergjent dhe të evakuimit si dhe të gjithë rrjetet e veçanta që kanë nevojë për këtë shërbim. Kështu do të kemi: 1 UPS i cili do të mbulojë konsumatorë të rrjetit kompjuterik dhe shërbimeve të tjera. Çdo sistem do të jetë i pajisur me kuadrin e tij elektrik të veçantë i cili do të mbulojë qarqet elektrike përkatëse. Ambjenti teknik në të cilin do të montohen këto UPS do të jetë i kondicionuar me një sistem të pavarur nga pjesa tjetër e objektit. 5.1. Të dhënat teknike 5.1.1. Satndartet EN 50091-1-1; Siguria me UPS EN 50091-2; Procedurat e testimit për përputhshmërinë elektromagnetike ndërmjet UPS dhe pajisjeve të tjera EN 50091-3: Performanca dhe metodat e testimit për UPS. CEI 146-4 5.1.2 Prodhimi i UPS Një njësi qendrore për UPS është instaluar në ambjentin e serverit afër dhomës së panelit të përgjithshëm, me bateri dhe ventilator. Njësia është tip e vetme pa reduktim por me by pass për shërbim dhe mirëmbajtje. Ky by pass nuk është pjesë e panelit qendror. Duhet të sigurohet nga një çelës me ngarkesë të veçantë të hapësira e njësisë. 5.1.3. Shpërndarja e UPS, Shpërndarja e UPS fillon te panelet e veçanta të UPS. Shtrirja e kablllove do të bëhet në të njëjtën rrugë kanalinash dhe kabllosh. Tipet e kablllove janë standarte (jo me ngjyra të përcaktuara). UPS i ofruar nga shoqëria jonë plotëson tërësisht specifikimet teknike të kërkuara. Për saktësim, referojuni pjesës së markuar me ngjyrë të verdhë në katalogun e ngarkuar në sistem.

Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë:

Ena e zgjerimit është një pajisje e thjeshtë dhe nuk vendoset në katalogët e pompave pasi për të njëjtin tip pompe, në varësi të konsumit, mund të vendosen enë zgjerimi me kapacitet të ndryshëm. Komisioni i vlerësimit të ofertave pretendon që ofertuesit të parqesin katalog për enën e zgjerimit ndërkohë që ajo është një aksesori dhe jo pjesë përbërëse e pandarë e pompës. Katalogët për pompat janë ngarkuar në sistem dhe japin gjithë të dhënat që prodhuesi ka gjetur se janë të rëndësishme. Theksojmë se tipi i pompave që ne kemi ofruar është prodhim cilësor me standarde europiane dhe plotëson të gjitha specifikimet teknike.

Lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit sqarojmë:

Në pikën 2.3.5. të Kërkesave të veçanta të kualifikimit kërkohet: 2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet që për të gjithë pajisjet e listuara në tabelën e mëposhtme, të deklarojnë/paraqesin katalogët ku të evidentohet plotësimi i specifikimeve teknike...”. Theksojmë se në asnjë rresht nuk është kërkuar që katalogët duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe kjo gjë është krejt normale pasi të dhënat që jepen në katalogë të këtij tipi janë në gjuhë teknike me simbole dhe shifra krejtësisht të kuptueshme nga çdo profesionist. KVO pretendon se, meqenëse gjuha

e përdorur është e përcaktuar në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika 4.7 "Gjuha shqipe", atëherë i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer, i noterizuar në gjuhën shqipe. Komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kuptojë se termat teknik në anglisht tashmë janë aq të përdorura sa që është e pamundur të shmangen. Vetë autoriteti kontraktor në projektet dhe specifikimet e ngarkuara në sistemin elektronik të prokurimit, ndonëse gjuha e dokumentave të tenderit është shqip, ka ngarkuar dokumenta që përmbajnë specifikime anglisht, si psh:

6.5 Pompë e Furnizimit me Ujë Sanitar. Grupi i furnizimit me ujë sanitar me 2 pompa Horizontale ON/OFF të lidhura në paralel: - Prurja = 5.7 m³/h (për secilën pompë); - H = 30 m; - 3x400V; 5.2 A; - Lidhjet: 2"; - Kolektorë çelik inox/galvanizuar; - Enë zgjerimi 25 litra; - Pjesët e pompave në kontakt me ujin: zingato;

6.4 Pompë e Sistemit të Mbrojtjes nga Zjarri Grupi i MNZ sipas EN12845 i përbërë nga 2 Pompa elektrike 2x4.5 kw (1 ne pune + 1 ne stand-by) ku secila jep Q = 4.2 m³/h; H = 35 m; Pompe Pilot "Jockey" 1x0.65 kw Grupi i MNZ kompletuar me Kit Testimi me Flowmeter, Panel Komandimi dhe Presostate për secilën pompë. Enë zgjerimi 24 lit për pompën pilot. Në dërgim: Xhunto antivibrante - 2 copë, valvola flutur DN50 - 2 copë, kolektor dërgimi DN50, valvola mos-kthimi DN50 - 2 copë.

12.1.1 Access control, të jetë një sistem standart, 230V AC, i pajisur me një panel kontrolli i cilësisë së lartë i cili përmbush të gjitha kërkesat e sistemit të akses kontrollit të avancuar.

13.2.1 Kamerate: Kamerate e brendshme IP Kamerate e brendshme IP përmbajnë një shumëllojshmëri opsionesh të ndryshme. Kamerate janë të pajisur me sensor imazhi Super Low Lux CMOS i cili lejon kamerën të sigurojë një pamje reale me ngjyra në errësirë. Kamera ka një portë për mini USB e cila suporton lidhje wireless nëpërmjet një adaptorit wi-Fi (i ndryshëm) ose duke e ruajtur në hapësirë të jashtme duke përsorur një USB të madhe.

14. SISTEMI I KOMUNIKIMIT TE TE DHENAVE I gjithë objekti do të ketë një sistem të mirëllogaritur të komunikimit, me lidhjet me internet nëpërmjet operatorëve që e ofrojnë këtë shërbim. Kështu do të ketë një Rack kryesor i cili do të komunikojnë me Rack-ët në katet e tjera, komunikimi realizohet nëpërmjet fibrës optike të tipit multimode OM3 për gjatësi që nuk e kalojnë 300 m dhe singelmode për gjatësi mbi 300 m që garantojnë transmetimin DWDM (40 e 100 Gps në vetëm një kopje të fibrës optike).

Nisur nga sa më sipër, është e qartë se nuk mund të pranohet pretendimi që operatori ekonomik duhet të përkthejë çdo term në gjuhën shqipe (theksojmë edhe pse nuk është kërkuar shprehimisht në kërkesën për kualifikim) ndërkohë që, ndonëse gjuha e dokumenteve standarte të tenderit është shqip, autoriteti kontraktor ka përdorur masivisht terma anglisht. Ky pretendim absurd i kushton buxhetit të shtetit miliona lekë dëm ekonomik.

Lidhur me arsyen e katërt të skualifikimit sqarojmë se:

Është e vërtetë që sigurimi i ofertës lëshuar nga CREDINS bank me nr. Serie 57-0000116, prot., 1083, nuk ka të shënuar datën, por në të është shprehur qartë emërtimi i objektit, numri i referencës në faqen e APP-së, depozita e derdhur nga Agri Construction pranë Banka Credins sh.a, si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik. Oferta nga ana jonë është dorëzuar në ditën e tenderit, më datë 16.01.2024 dhe antyrisht që afati i vlefshmërisë së sigurimit të ofertës prej 150 fillon pas kësaj date. Fakti që nga ana e KVO nuk ka interes për të sqaruar datën e prerjes së sigurimit të ofertës nga ana e Credins Bank, gjë që mund ta realizonte lehtësisht, tregon për një vlerësimin tendencioz e të paramenduar për

skualifikimin e ofertës tonë. I kërkojmë autoritetit kontraktor të kualifikojë shoqërinë tonë pasi ka përmbushur të gjitha specifikimet teknike dhe kërkesat për kualifikim.

Kërkojmë gjithashtu që të verifikohet nga komisioni i shqyrtimit të ankesës dokumentacioni i paraqitur nga shoqëritë BOE L.T.E CONSTRUCTION SHPK & “Colombo” SHPK, “LEON KONSTRUKSION” SHPK dhe “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK, pasi kemi dyshime të bazuara se dokumentacioni i paraqitur nga këto shoqëri është kontrolluar në mënyrë të përciptë dhe ato janë kualifikuar në shkelje të ligjit. Për shoqëritë e mësipërme kërkojmë të verifikohen: plotësimi i specifikimeve teknike për pajisjet e kërcuara. Disponimi i stafit teknik dhe specialistëve të pa angazhuar, siç kërkohet në kërkesat për kualifikim, disponimi i mjeteve të pa angazhuara në kontratat e shoqëritë kanë në process, pagesa e taksave doganore në vendet ku shoqëritë kanë ushtruar aktivitetet.

Gjithashtu, kërkojmë të verifikohen edhe gabimet aritmetike në oferta.

Në përfundim kërkojmë autoritetit kontraktor:

Të skualifikojë shoqëritë “LEON KONSTRUKSION” SHPK, “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK, BOE L.T.E CONSTRUCTION SHPK & “Colombo” SHPK, dhe të renditet në vend të parë shoqëria “Agri Konstruktion” SHPK.

Në të kundërt, duke qenë se shihet qartë se përzgjedhja ka qenë selective, për të ruajtur barazinë në tender duhet të skualifikohen të gjitha shoqëritë pjesëmarrëse dhe tenderi të përsëritet.

II.6.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 471/2 prot., datë 27.02.2024, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 471 prot, datë 27.02.2024.

Gjithashtu, nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet edhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të operatororëve ekonomikë pjesëmarrës “LEON KONSTRUKSION” SHPK, “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK, BOE L.T.E CONSTRUCTION SHPK & “Colombo” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6.2. Nëpërmjet shkresës me nr. 3786/35 prot., datë 13.03.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 471/3 prot., datë 18.03.2024 me objekt “Dërgohet Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se me Vendimin Nr. 3786/29 prot, datë 13.03.2024 autoriteti kontraktor ka vendosur:

1. **Të pranojë pjesërisht** ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK. Në përfundim të shqyrtimit, **ky operator ekonomik mbetet i skualifikuar.**
2. **Skualifikimin e “LEON KONSTRUKSION” SHPK, “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK, BOE L.T.E CONSTRUCTION SHPK & “Colombo” SHPK, sipas argumentave.**
3. **Dërgim vendimi të arsyetuar pranë KPP-së dhe operatorit ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK.**

II.6.3. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

II.6.4. Me shkresën nr. 471/4 prot., datë 21.03.2024, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor, duke kërkuar informacion: “Bazuar në nenin 113 dhe 114 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kërkojmë të na informoni për sa më poshtë:

1. *A I keni njoftuar operatorët ekonomikë “LEON KONSTRUKSION” SHPK, “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK, BOE L.T.E CONSTRUCTION SHPK & “Colombo” SHPK, mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “AGRI CONSTRUCTION” SHPK? Nëse po, ju lutem të na dërgoni kopje të librit të protokollit që vërteton njoftimin.*

II.6.5. Nëpërmjet shkresës me nr. 3786/39 prot., datë 26.03.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 471/5 prot., datë 27.03.2024 me objekt “Dërgohet informacion për shkresën tuaj me nr. 471/4 prot., datë 21.03.2024”, është depozituar nga autoriteti kontraktor, informacion mbi dërgimin e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, drejtuar subjekteve të interesuara.

II.7. Në datën 27.02.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 479/2024 prot, datë 27.02.2024 e operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi me pretendimet si më poshtë vijon:

Autoriteti kontraktor pretendon se për pikën 2.3.1 /b vlerësimi i përvojës së suksesshme për kontratat e realizuara me ente publike operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë. Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor, konkretisht puna është nënkontraktuar e gjitha tek operatori ekonomik “Trema Engineering 2” sh.p. k., i cili më pas ka nënkontraktuar një pjesë të punimeve tek operatori ekonomik “PEPA GROUP ” sh.p. k. Nga Autoriteti Kontraktor Ujësjiellës Kanaizime Kamëz sha., nuk ka asnjë miratim lidhur me nënkontraktimin e operatorit ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k për kryerjen e kësaj pjesë të

punimeve si dhe në kontratën bazë të nënkontraktimit midis “Trema Engineering 2” sh.p.k. dhe “STRABAG AG” nuk ka asnjë pikë lidhur me lejimin e nënkontraktimit. Nuk është paraqitur akti i kolaudimit, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” ku citohet se: “Të gjithë objekt e përkufizuara në nenin 3 duhet t’i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik...” ku në nenin 3 specifikohet. “Në kuptim të këtij ligji, nëse nuk përcaktohet ndryshe, punime ndërtimi quhen të gjitha punimet e ndërtimit për ndërtesat, objektet qytetare, veprat industriale, të infrastrukturës dhe për objektet e tjera.”

Në SPE nga ana e Operatorit Ekonomik Pepa Group shpk është ngarkuar dokumenti me emërtim “2.3.1-Pune e ngjashme Trema”, e cila përban dokumentacionet e mëposhtme:

-Formular Vlerësimi e shoqërisë ndërtimore “Trema Engineering 2” shpk për shoqërinë “Pepa Group” shpk për kontratën me objekt “Ndërtim i godinës së Administratës UKK përfshirë rrethimin dhe sistemimin e hapsirës përreth godinës”, Vlerësimi- Kontratë e përmbushur.

-Proces verbal i marrjes në dorëzim të përkohshëm i punimeve , Datë 30.04.2021, ndërmjet shoqërisë ndërtimore “Trema Engineering 2” shpk dhe shoqërisë “Pepa Group” shpk për kontratën me objekt “Ndërtim i godinës së Administratës UKK përfshirë rrethimin dhe sistemimin e hapsirës përreth godinës”.

-Proces verbal i marrjes në dorëzim përfundimtar i punimeve, Datë 30.04.2022, ndërmjet shoqërisë ndërtimore “Trema Engineering 2” shpk dhe shoqërisë “Pepa Group” shpk për kontratën me objekt “Ndërtim i godinës së Administratës UKK përfshirë rrethimin dhe sistemimin e hapsirës përreth godinës” së bashku me certifikatën e pagesës së vlerës së garancisë 5% të vlerës së punimeve, mbajtur gjatë periudhës së punimeve dhe garancisë së punimeve.

-Kontrata e sipërmarrjes datë 08.05.2020 me objekt “Ndërtim i godinës së Administratës UKK përfshirë rrethimin dhe sistemimin e hapsirës përreth godinës” ndërmjet shoqërisë ndërtimore “Trema Engineering 2” shpk dhe Nënkontraktorit “Pepa Group” shpk, me vlerë 528,071 euro me tvsh, ku është cituar që kjo kontratë është pjesë e projektit 794/1033 “Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit Kamëz”

-Faturat tatimore sipas 11 muajve përkatës

-Situacioni përfundimtar

-Kontrata nr. MIP IV-Kamza SCW-2019 , Datë 21 Shkurt 2020, me emër projekti “Infrastruktura e qytetit të Kamzes”, ndërmjet Ujësjellës kanalizime Kamëz (Punëdhënësi) dhe Strabag AG (Kontraktori), me vlerë 9,171,209 euro me tvsh . -E përkthyer dhe e njehësuar me origjinalin.

-Certifikatë e dorëzimit të përkohshëm pjesor të punimeve nënshkruar nga Supervizori i punimeve të kontratës kryesore. -E përkthyer dhe e njehësuar me origjinalin.

-Kontrata e nënkontraktimit , datë 15 Prill 2020 ndërmjet Stragabag AG (Kontraktori kryesor) dhe Nënkontraktorit “Trema Engineering 2” shpk -E përkthyer dhe e njehësuar me origjinalin.

-Certifikatë e dorëzimit të përkohshëm pjesor të punimeve nënshkruar nga Supervizori i punimeve të kontratës kryesore. -E përkthyer dhe e njehësuar me origjinalin.

-Email zyrtar sqarues nga përfaqësues i kompanisë “Trema Engineering 2” shpk për mungesën e Akt kolaudimit.

Në kontratën - Kontrata nr. MIP IV-Kamza SCW-2019, Datë 21 Shkurt 2020, me emër projekti “Infrastruktura e qytetit të Kamzës”, ndërmjet Ujësjetës Kanalizime Kamëz (Punëdhënësi) dhe Strabag AG (Kontraktori), janë përcaktuar kushtet e kontratës dhe zbatimi i saj sipas Fidic Pink Book MDB Edition 2010. Kjo kontratë është financuar nga Banka Europiane dhe zbatohen rregullat dhe politikat të prokurimit të BERZH.

Në kontratën - Kontrata e nënkontraktorit, datë 15 Prill 2020 ndërmjet Stragabag AG (Kontraktori kryesor) dhe Nënkontraktimit “Trema Engineering 2” shpk, janë përcaktuar kushtet e kontratës dhe zbatimi i saj sipas Fidic Pink Book MDB Edition 2010, ose rregullave dhe politikave të prokurimit të BERZH.

Në kontratën - Kontrata e sipërmarrjes datë 08.05.2020 me objekt “Ndërtim i godinës së Administratës UKK përfshirë rrethimin dhe sistemin e hapsirës përreth godinës” ndërmjet shoqërisë ndërtimore “Trema Engineering 2” shpk dhe Nënkontraktorit “Pepa Group” shpk, me vlerë 528,071 euro me tvsh, pika 1 e kontratës përcaktohet se “punimet, dispozitat, certifikata e nevojshme, dokumentat janë sipas Kontratës Kryesore”. Rrjedhimisht kushtet e kontratës dhe zbatimi i saj janë sipas Fidic Pink Book MDB Edition 2010.

Pretendimi i KVO-së se Autoritetit kontraktor për mungesën e **Aktit të kolaudimit** nuk qëndron, pasi për këtë është shprehur edhe KPP në Vendimi nr 35/2015 me objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Salillari” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt: “Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore Divjakë”, me fond limit 43.487.380 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.12.2014 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë”, me ankimues “Salillari” sh.p.k. e cila është skualifikuar për të njëjtën arsye nga KVO e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Divjakë: Për plotësimin e kriterit “Punë e ngjashme, është paraqitur kontrata me objekt “Ndërtimi i shkollave të reja në Shishtufinë dhe Fonderia Mekanike” për të cilën mungon situacioni përfundimtar dhe akti i kolaudimit për këtë objekt.

Njësia e Menaxhimit të Projekteve e Bashkisë Tiranë ka kthyer përgjigje zyrtare se: “Gjatë zbalimit të projekteve të financuara nga Banka Europiane për Rindërtin dhe Zhvillim mbështetur në Marrëveshjen e Huasë, janë përdorur procedurat e prokurimit sipas rregullave dhe politikave të prokurimit të BERZH.

Kontratat për punimet civile të përdorura janë kontrata e FIDIC. Në këtë kontratë janë parashikuar të gjitha procedurat dhe dokumentacioni për realizimin e punimeve që mbahen nga kontraktori si dhe kompetencat dhe dokumentat që certifikon dhe lëshon Mbikqyrësi i Punimeve, në përfundim të punimeve dhe në fund të periudhës së defekteve. Sipas kontratës, në përfundim të punimeve dhe mbas testeve të kryera, Mbikqyrësi i Punimeve (Engineer) lëshon certifikatën e Marrjes në Dorëzim (Taking — Over Certificate). Në përfundim të periudhës së defekteve, mbas konfirmimit se punimet janë kryer në rregull sipas kontratës, Mbikqyrësi i Punimeve lëshon certifikatën Finale të Pranimit ose certifikatën e Performancës (Performance Certificate).

Ashtu siç kemi cituar me sipër tek lista e dokumentacioneve, pjesë e punës ë ngjashme të “Pepa Group” shpk, ngarkuar në SPE, janë edhe Certifikatat e dorëzimeve të punimeve të përkohshme të datës, 22 Shtator 2021 dhe 11 shkurt 2022 . Këto Certifikata janë të lëshuara nga Mbikqyrësi i punimeve Dahlem Beratende Ingenieure / Setec Engineering.

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik në lidhje me punët e mëparshme të ngjashme. Kontrata e

paraqitur nga është e lidhur me një njësi projekti dhe dokumentacioni i mbajtur në këtë rast ndryshon nga ai i mbajtur për kontratat e lidhura për objekte të realizuara me fonde të buxhetit të shtetit shqiptar dhe rrjedhimisht edhe emërtimi i tyre nuk është i njëjtë.

Përsa i përket pretendimit të KVO-së se: “në kontratën bazë të nënkontraktimit midis “Trema Engineering 2” sh.p. k. dhe “STRABAG AG” mik ka asnjë pikë lidhur me lejimin e nënkontraktimit”, shpjegojme se nuk ka edhe asnjë pikë lidhur me moslejimin e nënkontraktimit.

Sqarojmë që ndryshe nga kontratat standarte TIP të përcaktuara në dokumentat e tenderit për procedura të lidhura midis Autoritetit Kontraktor dhe një operatori ekonomik sipas ligjit të Prokurimit Publik, në këtë rast marrëveshja është bërë sipas një formati tjetër kontrate, e cila përkon me rregullat e FIDIC, duke qenë se janë investime nga Organizata dhe institucione të huaja.

Theksojmë që Kontratat FIDIC janë rregullore jo-shtetërore dhe kanë ngjashmëri me ligjet e vendeve Anglo-Saksone.

Në këtë kontratë janë parashikuar të gjitha procedurat dhe dokumentacioni për realizimin e punimeve që mbahen nga kontraktori si dhe kompetencat e gjithësecilit.

Në asnjë dispozitë të kontratës kryesore nuk specifikohet që ndalohet nënkontraktimi i punimeve. Për aq kohë sa procedura e nënkontraktimit mbështetet mbi vullnetin e shprehur të palëve në formën e kontratës, automatikisht ky nënkontraktim është i vlefshëm dhe Autoriteti Kontraktor nuk mund të pretendoj pavlefshmëri e këtij të fundit vetën sepse nuk është miratuar zyrtarisht pasi si e shprehëm më sipër, ndodhemi përballë faktit që marrëdhëniet kontraktore dhe nënkontraktore rregullohet nga një format i huaj kontratë që nuk kërkon një formë zyrtare nënkontraktimi.

Përsa i përket pretendimit të KVO-së se: “Nga Autoriteti Kontraktor Ujësjetllësi Kanalizime Kamëz sh.a. nuk ka asnjë miratim lidhur me nënkontraktimin e operatorit ekonomik “PEPA GROUP sh.p. k. për kryerjen e kësaj pjese të punimeve” sqarojmë si më poshtë:

Pra mungesa e Vërtetimit nga UKK për PEPA GROUP shpk që ka qenë një nga nënkontraktorët për këtë kontratë, nuk e hedh poshtë faktin që PEPA GROUP shpk ka një nivel të mjaftueshëm përvoja të ngjashme, të realizuar me sukses, pasi vërtetohet nga të gjitha dokumentacionet e tjera të paraqitura dhe cituara më sipër.

Theksojmë që kontrata kryesore: Kontrata nr. MIP IV-Kamza SCW-2019 , Date 21 Shkurt 2020, me emër projekti: “Infrastruktura e qytetit të Kamzës”, lidhur ndërmjet Ujësjetllës kanalizime Kamëz (Punëdhënësi) dhe Strabag AG (Kontraktori), me vlerë 9,171,209 euro me tvsh nuk është një kontratë me fonde publike shtetërore, pasi financimi ka qenë nga Banka Evropiane. Nuk është kryer një procedurë prokurimi sipas LPP-së, por janë përdorur procedurat e prokurimit sipas rregullave dhe politikave të prokurimit të BERZH siç e prekem dhe më lart si fakt.

Rrjedhimisht UKK nuk mundej të jap një dokumentacion vërtetimi si nënkontraktor kur në asnjë dokument nuk është kërkuar detyrimisht një miratim i tillë.

Pra PEPA GROUP shpk nuk mund të paraqes një dokument egzistenca e të cilit nuk ka qenë një detyrim ose kriter për lindjen e një marrëdhënie kontraktuale sipërmarrjeje në formën e nënkontraktimit.

Po ashtu edhe KVO e Autoritetit kontraktor Universiteti i Mjekësisë, nuk mund të përdor si arsye skualifikimi mungesën e një dokumenti që nuk është kërkuar ligjërisht, në procedurat fillestare kur është kryer kontrata kryesore midis UKK dhe Strabag AG, dhe nuk cënon aspak lindjen e marrëdhënieve për zbatimin e punimeve në fushën e ndërtimit.

Puna e ngjashme e paraqitur në SPE, është një punë e ngjashme në sektor privat, për të cilin ska nevojë për vërtetimin si nënkontraktor i PEPA GROUP shpk.

KPP në vendimin nr 35/2015 me objekt: “Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Salillari” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt: “Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore Divjakë”, me fond limit 43.487.380 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.12.2014 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë, me ankimues “Salillari” sh.p.k sqaron se: projektet me fondet e vëna në dispozicion nga donatorë apo institucione ndërkombëtare financimi, i referohen procedurave të prokurimit sipas rregullave dhe politikave të prokurimit të BERZH, the jo legjislacionit për prokurimin publik shqiptar. Rrjedhimisht edhe dokumentacioni që mbahet në rastin e lidhjes së kontratës dhe pas përfundimit të saj është i ndryshëm për kontratat e lidhura me fonde të buxhetit të shtetit shqiptar. Për një autoritet kontrakt është e rëndësishme të vërtetohet se një operator ekonomik ka paraqitur dokumentacion në lidhje me punët e mëparshme të ngjashme, pa pasur rëndësi emertimi i dokumentit. Lidhur me aktin e kolaudimit për kontratat e financura me fonde jo të buxhetit të shtetit shqiptar, një dokument i tillë, nuk lëshohet, por pas konfirmimit se punimet janë kryer në rregull sipas kontratës lëshohet dokumenti Certifikatë Finale e Pranimit, dokument i cili në rastin konkret është paraqitur nga PEPA GROUP shpk.

Përsa më sipër kërkojmë nga KPP:

-Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt: “Rikonstruksioni i godines se anatomisë”, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.”, me fond limit 80,128,758.52 (tetedhete milion e njeqind e njezet e tete mijë e shtateqind e pesedhete e tete presje pesedhete e dy) leke pa tvsh, zhvilluar në datën 16.01.2024. nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

-Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pepa Group” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator.

II.7.1. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 479/2 prot., datë 27.02.2024, me arsyet e skualifikimit dhe pretendimin që operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 479/2024 prot, datë 27.02.2024.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK me arsyetimin si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k. me NUIS: L42215009L nuk përmbush kriteret si më poshtë:

1. Për pikën 2.3.1 /b vlerësimi i përvojës së suksesshme për kontratat e realizuara me ente publike operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor, konkretisht puna është nënkontraktuar e gjitha tek operatori ekonomik “Trema Engineering 2” sh.p.k., i cili më pas ka nënkontraktuar një pjesë të punimeve tek operatori ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k. Nga Autoriteti Kontraktor Ujësjiellësi Kanalizime Kamëz sh.a. nuk ka asnjë miratim lidhur me nënkontraktimin e operatorit ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k. për kryerjen e kësaj pjese të punimeve si dhe në kontratën bazë të nënkontraktimit midis “Trema Engineering 2” sh.p.k. dhe “STRABAG AG” nuk ka asnjë pikë lidhur me lejimin e nënkontraktimit.

- Nuk është paraqitur akti i kolaudit, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” ku citohet se: “Të gjitha objektet epërkufizuara në nenin 3 duhet t’i nënshtrohen kolaudit tekniko ekonomik...” ku në nenin 3 specifikohet: “Në kuptim të këtij ligji, nëse nuk përcaktohet ndryshe punime ndërtimi quhen të gjitha punimet e ndërtimit për ndërtesat, objektet qytetare, veprat industriale, të infrastrukturës dhe për objektet e tjera.”

II.7.2. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

II.7.3. Nëpërmjet shkresës me nr. 3786/35 prot., datë 13.03.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 479/3 prot., datë 18.03.2024 me objekt “Dërgohet Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave”, është depozituar nga autoriteti kontraktor, akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “PEPA GROUP” SHPK, ku konstatohet, se me Vendimin Nr. 3786/31 prot, datë 13.03.2024 autoriteti kontraktor ka vendosur:

- 1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, ky operator ekonomik mbetet i skualifikuar.**
- 2. Dërgim vendimi të arsyetuar pranë KPP-së dhe operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK.**

II.7.4. Me shkresën nr. 38 prot., datë 15.03.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 479/4 prot., datë 20.03.2024, me objekt “Përcjellje informacioni plotësues”.

II.8. Në datën 28.02.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi A/2024/3840 dhe me nr. 487/2024 prot., datë 28.02.2024 e operatorit ekonomik “INERTI” SHPK për procedurën e prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “INERTI” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit objekt - shqyrtimi me pretendime si më poshtë vijon:

Për sa më sipër, autoriteti kontraktor e ka skualifikuar ofertën tonë me arsyetimin e mëposhtëm:

? Për pajisjen Nr. 4 Kamera të Brëndshme Operatori Ekonomik ka paraqitur DH IPCHF2541-Z IZ SENSE në fq 41-48. Kjo kamera ka kryesisht përdorim të jashtëm dhe jo të brëndshëm, shprehur kjo në katalogun e produktit, por që bie në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

? Në vijim Autoriteti Kontraktor pretendon se Nuk plotësohet specifikimi teknik: - IR Dome kamera - DDR

Për sa më sipër sqarojmë që në tabelë është bërë një lapsus i vogël duke paraqitur kamerën e jashtme si të brendshme për shkak të ngatërresës së numrit rendor. Konkretisht kamera DH IP-HD2441TM-S IZ SENSE është kamera e përdorimit të brendshëm brenda çdo parametri të kërkuar duke përfshirë dhe llojin IR Camera e cila ka të gjitha funksionet e kërkuara nga AK, çka mund të vërtetohet fare mirë dhe teknikisht. Autoriteti Kontraktor, duke qenë i mirëinformuar për çdo produkt që ka kërkuar në këtë procedurë, duhet ta ketë dalluar qartazi që të dyja llojet e kamerave janë të paraqitura në katalogje pavarësisht vendosjes së tyre në tabelë. Qëllimet tendencioze për të skualifikuar shoqërinë tonë duke kërkuar patjetër arsye të paarsyeshme duken qartazi që në këtë pikë.

? Për pajisjen Nr. 5 Kamera të Jashtme Operatori Ekonomik ka paraqitur DH IP-HD2441TM-S IZ SENSE në fq 35-47. Nuk plotësohet specifikimi teknik: - IR Bullet kamera - VF Lens 2,8-12 mm - DDR

Si e sqaruam dhe më sipër, bëhet fjalë për një ngatërres në numrin rendor në tabelë. Konkretisht kamera DH IPCHF2541-Z IZ SENSE është për përdorim të jashtëm 5 Mp çka do të thotë që kapaciteti i saj maksimal është 5 duke përfshirë dhe tejkualuar 3 Mp, cilësohet qartësisht që është një IR Bullet kamera - VF dhe kanë një gjatësi max prej 13 mm. Autoriteti kontraktor nuk mund të refuzoj një model kamere më të avancuar e cila i përfshin dhe tejkalon të gjitha kapacitetet e kërkuara qoftë në faktorë largësie, qartësie imazhi, detektimi etj. Pra ky kriter është plotësisht i përmbushur.

? Autoriteti Kontraktor gjykon se: Për pajisjen Nr. 5 Gjenerator Diesel. Në katalogun e paraqitur nuk specifikohet modeli i caktuar dhe kjo pajisje nuk plotëson pikën 2.3.6 të DST-së. Janë paraqitur disa modele që nuk i përkasin firmës që ka deklaruar si prodhuese. Firma e deklaruar është kompani Shaqiptare e cila mund ti tregëtojë këto pajisje. Sqarojmë që për pajisjen Gjenerator Diesel, nga autoriteti kontraktor nuk është kërkuar asnjë model i caktuar. Është kërkuar thjesht paraqitja e katalogut për Gjenerator diesel S = 45 kVA / , Un =400V, silencioze, deri 60db për 7m, komplet me kuadrin automatik dhe gjithçka të nevojshme sipas standartit. Duke qenë se këto produkte nuk kanë një distributor zyrtar pasi kanë marrëveshje me disa tregtar ku një ndër to është dhe Fredi Gjenerator nga faqja zyrtare e e të cilit janë marrë dhe këto materiale, atëhere kemi deklaruar këtë të fundit në shtojcë. Në katalog pasqyrohet qartë fuqia e kërkuar e gjeneratorëve me të dhënat respektive për secilin nga modelet. Sqarojmë se, të gjitha katalogjet e deklaruar janë të një formati zyrtar, të dërguar nga kompanitë prodhuese duke na i vënë në dispozicion me anë të distributorit të autorizuar. Këto katalogje janë të një formati standart dhe nuk mund të modifikohen apo përshtaten kërkesave për procedura të ndryshme pasi kemi të bëjmë me katalogje të cilat dalin nga prodhuesi në nivel nderkombetar për mallin që prodhojnë.

Nëse Autoriteti Kontraktor kërkon informacion më specifik, i cili si e shpjeguar më lart nuk paraqitet në katalogjet që kanë format standart, mund të kërkonte informacion në çdo kohë sipas pikës 7 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, ndërsa në pikën 2 të nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se “Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës”.

? Për paisjen Nr. 8 është kërkuar Grupi MNZ: - Tek kjo paisje janë paraqitur vetëm specifikimet për pompat por pa specifikuar mënyrën e vendosjes apo pozicionimin që kanë këto pompa në Grupin MNZ. Meqënëse në katalog janë paraqitur elementët veç e veç këtu mungojnë element të Grupit MNZ si Paneli Komandimit dhe presostate për secilën pompë; si dhe Enët e zgjerimit; - Mungon Enë zgjerimi 24 litra për pompën pilot; - Mungon Xhunto antivibrant, Mungon Valvola flutur DNS50; - Mungon Kolektori dërgimit; - Mungon Valvola mos-kthimit DNS00 është paraqitur DN40; - Është e paqartë mënyra si do të lidhen këto dy pompa, pasi dhe valvulat janë në dimensione të ndryshme. Pompa cetrifugale ka një valvul më të madhe se pompa vertikale, e cila mund të cojë në shpërthimin e pompës vertikale për shkak të prurjes më të madhe se ajo vertikale.

Dhe në rastin konkret jemi përballë të njëjtij fakt dhe ritheksojmë që të gjitha katalogjet e deklaruar, ndër to dhe katalogjet për pompat, janë të një formati zyrtar, të dërguar nga kompanitë prodhuese duke na i vënë në dispozicion me anë të distributorit të autorizuar. Këto katalogje janë të një formati standart dhe nuk mund të modifikohen apo përshtaten kërkesave për procedura të ndryshme pasi kemi të bëjmë me katalogje të cilat dalin nga prodhuesi në nivel ndërkombëtar për mallin që prodhojnë.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 1, thuhet se: “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Duket qartazi tendenca për të skualifikuar padrejtësisht një subjekt që plotëson çdo element kryesor të kapacitetit financiar dhe teknik, me një eksperiencë 33 vjeçare që operon në tregun shqiptar. Ak nuk mund të paragjykoj si difektoze një brand global të prodhimit të pompave në formën e lidhjes së valvulave duke shfaqur paqartësi dhe gjykime apriori me arsyetime qesharake që pompa mund të shpërthejë pasi çdo kompani bën analiza dhe prova para se të hedhi një produkt në treg.

Për sa më sipër, në katalog janë paraqitur elementët më të rëndësishëm përbërës të këtyre pompave. Nëse autoriteti kontraktor kërkon informacion më specifik, i cili si e shpjeguar më lart nuk paraqitet në katalogjet që kanë format standart, mund të kërkonte informacion në çdo kohë sipas pikës 7 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor

ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”, ndërsa në pikën 2 të nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se “Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës”

? Për pajisjen Nr. 9 është kërkuar Grupi i furnizimit me ujë sanitar: Tek kjo paisje janë paraqitur në katalog specifikimet për pompën e ujit ku nuk plotësohet specifikimi teknik për: - Për pompën SD30 në tabelë janë 4 tipe dhe nuk është markuar modeli të cilit i referohet operatori; - Mungojnë lidhjet 2 e cila konvertohet me 63mm nuk plotësohet ky specifikim; - Mungon specifikimi për enën e zgjerimit 25 litra që nuk është paraqitur fare në katalog; - Nuk plotëson kapacitetin 400V pasi operatori ekonomik e ka paraqitur 220V - 380V.

Në katalogjet e ngarkuar në DST nuk është vetëm një model pompe por janë disa modele pompash të cilat megjithëse nuk kanë kapacitetin 400 V, nga ana mekanike janë të njëjta duke arritur të njëjtin funksionalitet të kërkuar nga Ak. Këto katalogje janë dorëzuar në bashkëpunim me ekspert të fushës të cilët na kanë siguruar që këto produkte kanë të njëjtin funksionalitet gjë që plotëson kushtet dhe specifikimet teknike që keni kërkuar ju si institucion. Ne shtojcë është deklaruar dhe faqja zyrtare e distributorit të autorizuar për çdo produkt duke i dhënë mundësinë AK të verifikojë këto të dhënat dhe të shohi gamën e gjerë të produkteve që këto disponojnë pasi si theksuam më sipër jo çdo produkt disponon katalog me specifikimet e kërkuara. Autoriteti kontraktor, me anë të informacionit që i kemi vënë në dispozicion në shtojcën e kërkuar prej tyre, mund të kontrakttoj lehtësisht me këta distributorë për të konfirmuar disponimin dhe testimin e këtyre produkteve edhe fizikisht nëse do jetë e nevojshme. ? Për pajisjen Nr. 12 dhe Nr. 13 Tek këto pajisje nuk përcaktohet se cili model UTH3 është sipas katalogut të paraqitur dhe cili model UTH4 është sipas katalogut. Tipi i pajisjes nuk është i markuar si model dhe është e vështirë të kuptohen specifikimet.

Fakti që autoriteti kontraktor nuk arrin të dalloj në katalog element të materialeve të kërkuara nuk duhet të konsiderohet kusht për skualifikim pasi këto katalogje janë paraqitur sipas kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe ky i fundit në çdo kohë mund të kërkojë informacion sqarues sipas pikës 7 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”, ndërsa në pikën 2 të nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se “Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës”.

Për pajisjen Nr. 16 Nuk plotëson specifikimet teknike: - Kapaciteti në ftohje/ngrohje 5.00/5.50 k 2.

Katalogjet që kemi ngarkuar konsistojnë në modele të ndryshme të cilat kanë kapacitete të ndryshme ngrohje ftohje sipas modelit respektiv të cilat arrijnë kapacitete qoftë dhe më të

mëdha se ato të kërkuara, gjë e cila nga ana teknike nuk përbën aspak problem për sistemet e ngrohje/ftohjes pasi qëllimi i funksionalitetit të tyre realizohet plotësisht.

? Katalogjet teknike janë paraqitur anglisht dhe të përkthyer në shqip por mungon firma dhe vula në çdo faqe e përkthyeses:

Në faqen e fundit të vërtetimit të përkthimit me nr. 130 rep dhe nr. 131 rep, datë 12/01/2024 citohet:

Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili/a më deklaroi se përkthehu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkëngjitur “deklaratë noteriale”, nga gjuha Anglisht në gjuhën Shqip dhe e nënshkroi rregullisht para meje noterit”. Nga vërtetimi i përkthimit dokumentacioni nuk është deklaratë noterale (por katalogje si dhe nuk është e nënshkruar nga përkthyesi, në kundërshtim me nenin 135 të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, ku citohet se: Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes të përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi”.

Për sa më sipër, sqarojmë që cilësimi “deklaratë noteriale” është një lapsus i bërë nga noteri, çka vërtetohet dhe me deklaratën e këtij të fundit bashkëngjitur këtij ankimi. Në fund të Vërtetimit të përkthimit është dhe vula e përkthyeses e cila konfirmon përkthimin në fjalë. I gjithë dokumentacioni i paraqitur përmban vulën e noterit Alket B Skenda i cili vërteton që ky dokument është i përkthyer nga përkthyesja e licensuar Znj. Jonida Tatazi konform nenit 135 të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” ku citohet Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi”.

Në rastin konkret Autoriteti Kontraktor është duke realizuar haptazi një Keqpërdorim të fondeve publike duke skualifikuar ofertat me çmim më të ulët dhe duke kualifikuar oferta ekstremisht shumë të larta duke i sjellë shtetit një dëm prej miliona lekësh.

Për aq kohë sa një produkt arrin teknikisht të njëjtin rezultat me një produkt tjetër analog i cili mund të ketë specifikime të tjera ose format tjetër procesimi, atëherë kriteri funksional i kërkuar nga AK konsiderohet i përmbushur. Jo domosdoshmërisht mungesa e një valvule e bën një pompë jo funksionale pasi ajo mund të ketë format tjetër procesimi i cili arrin prurje të njëjta me ato të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Për sa më sipër, nëse shohim FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK) të Publikuar vërejmë që 70% e kompanive të skualifikuara kanë të njëjtën arsye absurde si madhësitë e valvulave të pompës, xhunto antivibrante, kolektor dërgimi. Kompani lider të cilat operojnë prej vitesh në treg të skualifikuara për një xhunto antivibrante?! Nuk janë pak të çuditshme këto kritere tendencioze të vendosura nga Ak?! Këtu kemi qartazi një ngushtim artificial të konkurrencës në shkelje të nenit 3 pika 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,

Si mundet një kompani si e jona që zotëron një arsenal të plotë mjetesh dhe burimesh njerëzore, me një portofol projektesh me rëndësi të madhe publike të skualifikohet për një valvul pompe, një emërtim gjeneratori apo një xhunto antivibrante të cilat ndoshta nuk diktohen në katalogje se janë element dytësor dhe jo parësor por të cilat mund ti aksesojmë lehtësisht nga çdo kompani e mundshme që i disponon në tregun shqiptar duke ja vënë në dispozicion AK nëse ky i fundit do kërkonte sqarime për këto të fundit.

Kjo është një lojë fjalësh që autoriteti Kontraktor paturpësisht ka përdorur duke u fshehur në interpretime të mbrapshta të ligjit.

Sa më sipër kërkojmë të KUALIFIKOJNË OFERTËN TONË.

Duke qartazi që ky institucion është i përfshirë në afëra korruptive ndaj i Kërkojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, e vënë në dijeni për këtë ankesë, të marrë masa të menjëhershme për fillimin e procedurave për hetim administrativ ndaj anëtarëve të KVO-së, për skualifikimet e bëra në shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe Rekomandimeve tuaja ,të vendosura në Dokumentat Standarte të Tenderit, si dhe duke shkelur parimet e Ligjit të Prokurimit Publik

II.8.1. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 487/2 prot., datë 29.02.2024, me arsyet e skualifikimit dhe pretendimin që operatori ekonomik “INERTI” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 487/2024 prot, datë 29.02.2024.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar operatorin ekonomik “INERTI” SHPK me arsyetimin si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “INERTI” sh.p.k. me NUIS: J66926804L nuk përmbush kriteret si më poshtë:

2. *Për pikën 2.3.6 ku operatorët për të gjitha artikujt/pajisjet e listuara në tabelën pika 2.3.5 e DST, duhet të paraqesin katalogë ose broshura. Në katalog duhet të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Sa më sipër ky operator nuk plotëson specifikimet konkretisht:

Për pajisjen Nr. 4 Kamera të Brendshme

Operatori Ekonomik ka paraqitur DH IPCHF2541-Z IZ SENSE në fq 41-48. Kjo kamera ka kryesisht përdorim të jashtëm dhe jo të brëndshëm, shprehur kjo në katalogun e produktit, por që bie në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Nuk plotësohet specifikimi teknik:

- IR Dome kamera

- DDR

Për pajisjen Nr. 5 Kamera të Jashtme

Operatori Ekonomik ka paraqitur DH IP-HD2441TM-S IZ SENSE në fq 35-47.

Nuk plotësohet specifikimi teknik:

- IR Bullet kamera
- VF Lens 2,8–12 mm
- DDR

Për paisjen Nr. 5 Gjenerator Diesel

Në katalogun e paraqitur nuk specifikohet modeli i caktuar dhe kjo pajisje nuk plotëson pikën 2.3.6 të DST-së. Janë paraqitur disa modele që nuk i përkasin firmës që ka deklaruar si prodhuese. Firma e deklaruar është kompani Shqiptare e cila mund ti tregëtojë këto pajisje. Nuk është paraqitur katalogu origjinal i prodhuesit.

Për paisjen Nr. 8 është kërkuar Grupi MNZ:

- Tek kjo paisje janë paraqitur vetëm specifikimet për pompat por pa specifikuar mënyrën e vendosjes apo pozicionimin që zënë këto pompa në Grupin MNZ. Meqënëse në katalog janë paraqitur elementët veç e veç këtu mungojnë element të Grupit MNZ si Paneli Komandimit dhe presostate për secilën pompë; si dhe Enët e zgjerimit;
- Mungon Enë zgjerimi 24 litra për pompën pilot;
- Mungon Xhunto antivibrant;
- Mungon Valvola flutur DN50;
- Mungon Kolektori dërgimit;
- Mungon Valvola mos-kthimit DN50 është paraqitur DN40;
- Është e paqartë mënyra si do të lidhen këto dy pompa, pasi dhe valvulat i kanë në dimensione të ndryshme. Pompa cetrifugale ka një valvul më të madhe se pompa vertikale, e cila mund të çojë në shpërthimin e pompës vertikale për shkak të prurjes më të madhe se ajo vertikale.

Për pajisjen Nr. 9 është kërkuar Grupi i furnizimit me ujë sanitar:

Tek kjo paisje janë paraqitur në katalog specifikimet për pompën e ujit ku nuk plotësohet specifikimi teknik për:

- Për pompën SD90 në tabelë janë 4 tipe dhe nuk është markuar modeli të cilit i referohet operatori;
- Mungojnë lidhjet 2” e cila konvertohet me 63mm nuk plotësohet ky specifikim;
- Mungon specifikimi për enën e zgjerimit 25 litra që nuk është paraqitur fare në katalog;
- Nuk plotëson kapacitetin 400V pasi operatori ekonomik e ka paraqitur 220V – 380V.

Për pajisjen Nr. 12 dhe Nr. 13

Tek këto pajisje nuk përcaktohet se cili model UTH3 është sipas katalogut të paraqitur dhe cili model UTH4 është sipas katalogut. Tipi i pajisjes nuk është i markuar si model dhe është e vështirë të kuptohen specifikimet.

Për pajisjen Nr. 16 Nuk plotëson specifikimet teknike:

- Kapaciteti në ftohje/ngrohje 5.00/5.50 k.

2. Katalogjet teknike janë paraqitur anglisht dhe të përkthyer në shqip por mungon firma dhe vula në çdo faqe e përkthyesit. Në faqen e fundit të vërtetimit të përkthimit me nr. 130 rep dhe nr. 131 rep, datë 12/01/2024 citohet: “Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili/a më deklaroi se përkthehu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur “deklaratë noteriale”, nga gjuha Anglisht në gjuhën Shqip dhe e nënshkroi rregullisht para meje noterit”. Nga vërtetimi i përkthimit dokumentacioni nuk është deklaruar noteriale por katalogje si dhe nuk është e nënshkruar nga përkthyesi, në kundërshtim me nenin 135 të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, ku citohet se: “Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj

në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes të përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi”.

II.8.2. Në datën 01.03.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa nga shërbimi postar, me nr. 487/3 prot, datë 01.03.2024 e operatorit ekonomik “INERTI” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt – shqyrtimi.

II.8.3. Me shkresën nr. 2036/1 prot., datë 01.03.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 487/4 prot., datë 06.03.2024 me objekt “*Kthim - përgjigje*”, nga Agjencia e Prokurimit Publik.

II.8.4. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

II.8.5. Nëpërmjet shkresës me nr. 3786/35 prot., datë 13.03.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 487/5 prot., datë 18.03.2024, me objekt “*Dërgohet Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “INERTI” SHPK, ku konstatohet, se me Vendimin Nr. 3786/33 prot, datë 13.03.2024 autoriteti kontraktor ka vendosur:

1. ***Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INERTI” SHPK. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, ky operator ekonomik mbetet i skualifikuar.***
2. ***Dërgim vendimi të arsyetuar pranë KPP-së dhe operatorit ekonomik “INERTI” SHPK.***

II.9. Nga shqyrtimi i ankesës rezulton, se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e KVO-se mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INERTI” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative*”, si dhe nenit 23 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore, në mjediset e institucionit tonë, me përfaqësues ekspert fushe të operatorit ekonomik “INERTI” SHPK si dhe përfaqësues ekspert fushe, anëtarë të njësisë së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nga ana e autoritetit kontraktor, të cilët ka qenë pjesë e grupit të punës të ngritur për vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.. Për këtë qëllim iu drejtua me shkresën nr. 487/6 prot., datë 02.04.2024 operatorit ekonomik “INERTI” SHPK dhe autoritetit kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për t’u

paraqitur në seancë dëgjimore pranë ambienteve të KPP-së, ditën e premte, datë 05.04.2024 ora 11:00.

II.10. Në seancën dëgjimore të datës 05.04.2024 të zhvilluar në mjediset e KPP-së në prani të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, u paraqitën përfaqësuesit e operatorit ekonomik “INERTI” ShPK (Z. F. M, Z. M. GJ, Z. A. B, Z. A. T, Znj.O. M,) dhe përfaqësues nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, me detyrë inxhinier ndërtimi Znj. N. D, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Përfaqësuesit e operatorit ekonomik ankimues dhe të autoritetit kontraktor nuk kishin ndonjë kontestim gjatë seancës dëgjimore. Seanca dëgjimore u regjistrua në audio.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “AGRI CONSTRUCTION” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shkresës me nr. 3786/35 prot., datë 13.03.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 471/3 prot., datë 18.03.2024 me objekt “*Dërgohet Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se me Vendimin Nr. 3786/29 prot, datë 13.03.2024, autoriteti kontraktor ka vendosur:

- 1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK. Në përfundim të shqyrtimit, ky operator ekonomik mbetet i skualifikuar.**
- 2. Skualifikimin e “LEON KONSTRUKSION” SHPK, “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK, BOE L.T.E CONSTRUCTION SHPK & “Colombo” SHPK, sipas argumentave.**
- 3. Dërgim vendimi të arsyetuar pranë KPP-së dhe operatorit ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK.**

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

Lidhur me pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, KSHA ka vendosur si më poshtë vijon:

Arsyeja 1 e skualifikimit: *Nuk ploteson specifikimet teknike per paisjen Nr. 7 “U.P.S. 15 KVA, 3 fazor 10 min autonomi”. Operatori ekonomik e ka paraqitur pajisjen UPS lPh +N dhe jo tre fazor siç eshte kerkuar ne specifikimet teknike.*

Lidhur me kete arsye per skualifikim Operatori Ekonomik pretendon sa vijon:

“UPS i ofruar nga shoqeria jone ploteson teresisht specifikimet teknike te kerkuara. Per sakesim, referojuni pjeses se markuar me ngjyre te verdhe ne katalogun e ngarkuar ne sistem”. Personi i ngarkuar me shqyrtimin e ankeses konstatoi se ne faqen 1 te katalogut te ngarkuar ne sistem per paisjes “U.P.S. 15 KVA, 3 fazor 10 min, autonomi” jepen specifikimet teknike te paisjes se ofruar EVO DS PLUS TM me kod FGCEVDP15TM2/00. Tek specifikimi “Numri i fazeve” shenohet 3Ph+n, pra paisja eshte tre fazore. Gjithashtu tek specifikimi “Tensioni nominal” shenohet 360Vac/380Vac/400Vac/415Vac. Specifikimi Teknik per kete paisje plotesohet. **Pretendimet e Operatorit Ekonomik per kete pike qendrojne.**

Arsyeja 4 e skualifikimit: Nuk permbush kriterin per paraqitjen e sigurimit te ofertes pasi tek sigurimi i ofertës nuk është caktuar data kur është prerë sigurimi për tu paraqitur në këtë procedurë si dhe ngn nis afati 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë i vlefshimërisë.

Lidhur me kete arsye per skualifikim Operatori Ekonomik pretendon sa vijon:

“Eshte e vertete qe sigurimi i ofertes leshuar nga CREDDINS bank me nr. Serie 57 -0000116, Prot. 1083, nuk ka te shenuar daten, por ne te eshte shprehur qarte emenimi i Objektivit, numeri i References ne faqen e APP-se, depozita e derdhur nga Agri Construction prane Banka Credins sh.a.,si kusht per sigurimin e ofertes, dorezuar nga operatori i lartpermendur ekonomik. Oferta nga ana jone eshte dorezuar ne ditën e tenderit, me date 16.01.2024 dhe natyrisht qe afati e vlefshmerise se sigurimit te ofertes prej 150 (njëqind e pesëdhjetë dite) fillon pas kesaj date. Fakti qe nga ana e Konisionit te Vleresimit te Ofertave nuk ka interes per te sqaruar daten e prerjes se sigurimit te ofertes nga ana e CREDINS bank, gje qe mund ta realizonte lehtesisht, tregon per nje vleresim tendencioz e te paramenduar per skualifikim te ofertes tone. I kerkojme autoritetit kontraktor te kualifikojte shoqerine tone pasi ka permbushur te githe specifikimet teknike dhe kerkesat per kualifikim”.

Personi i ngarkuar me shqyrtimin e ankeses konstatoi se Formulari i sigurimit te ofertes eshte leshuar nga shoqeria nga “Credins Bank” dhe mban kodin 57-0000116 dhe numrin e protokollit 1083. Ky formular nuk mban date por ka te shenuar “Ky sigurim eshte i vlefshem per periudhen e specifikuar 150 (njëqind e pesëdhjetë) dite”. Personi i ngarkuar me shqyrtimin e ankeses gjykon se ky mund te konsiderohet nje devijim i vogel qe nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Lidhur me kete arsyetim Personi i ngarkuar me shqyrtimin e ankeses u bazua ne nenin 92, pika 3, te Ligjit 162/220 “Per Prokurimin Publik” ku, nder te tjera, citohet: “Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa preku përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”. **Pretendimet e Operatorit Ekonomik per kete pike qendrojne.**

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit

115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Për sa më sipër citur, bazuar në nenin 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar dhe do të vazhdojë shqyrtimin për pjesën tjetër të ankesës për procedurën e prokurimit objekt – ankimi.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “AGRI CONSTRUCTION” SHPK”, mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit “**Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë:** Ena e zgjerimit është një pajisje e thjeshtë dhe nuk vendoset në katalogët e pompave pasi për të njëjtin tip pompe, në varësi të konsumit, mund të vendosen enë zgjerimi me kapacitet të ndryshëm. Komisioni i vlerësimit të ofertave pretendon që ofertuesit të parqesin katalog për enën e zgjerimit ndërkohë që ajo është një aksesori dhe jo pjesë përbërëse e pandarë e pompës. Katalogët për pompat janë ngarkuar në sistem dhe japin gjithë të dhënat që prodhuesi ka gjykuar se janë të rëndësishme. Theksojmë se tipi i pompave që ne kemi ofruar është prodhim cilësor me standarde europiane dhe plotëson të gjitha specifikimet teknike. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

SHTOJCA 7 BEHET:

2.3.5 *Operatorët ekonomikë duhet që për të gjitha pajisjet e listuar në tabelën e mëposhtme, të deklarojnë/paraqesin kataloget ku te evidentohet plotesimi i specifikimeve teknike:*

Nr.	Emërtimi i pajisjes	Specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve dhe nr. i faqes se katalogëve për çdo artikull/pajisje etj.	Kompania prodhuese, Ëeb, E-mail, Nr. kontakti
1	Central telefonik PABX 4 hyrje / 40 dalje		
2	Centrali I alarmit per menaxhim te hyrjes se kontrolluar dhe alarmit per hyrje te padeshiruar me mundesi komunikimi ne rrjet dhe zgjerimi te mevonshem		
3	NVR 24, IP Kanale, Up to 32-ch IP cameras input, Third-party netëork cameras supported, ONVIF protokoll, Up to 5 Megapixels resolution recording, HDMI and VGA output at up to 1920×1080P resolution, HDD quota and group management, RAID Function, 4 SATA, 2 USB2.0, RS-232 interface, LAN interface, RS-485 interface, Controller port, Alarm in and Alarm out, Ground, AC 100V ~ 240V, etj		
4	Kamera te brendshme, IR Dome kamera 3MP 2.8mm, 3MP high resolution, HD real-time video, 3D DNR & DEDR & BLC, IR LEDs: up to 30m, IP66, Vandal-proof, PoE		
5	Kamera te jashtme, IR Bullet kamera 3MP, VF Lens 2,8-12 mm, 3 megapixel high resolution, HD video output, Loë illumination, 3D DNR & DEDR & BLC, IP66 rating, IR range: up to 30m, True day / night, POE interface		
6	Gjenerator diesel S = 45 kVA /, Un =400V, silencioze, deri 60db per 7m, komplet me kuadrin automatik dhe gjithcka te nevojshme sipas standartit.		
7	U.P.S. 15 KVA, 3 fazor 10 min, auotonomi.		
8	Grupi i MNZ sipas EN12845 i perbere nga 2 Pompa elektrike 2x4.5 kw (1 ne pune + 1 ne stand-by) ku secila jep: Q=4.2 m³/h; H=35 mkH₂O; Pompe Pilot "Jockey" 1x0.65 kw, Hydro EN-S2 32-200/219 - 98925936 Grupi i MNZ kompletuar me Panel Komandimi dhe Presostate per secilen pompe. Ene zgjerimi 24 lit per pompen pilot. Xhunto antivibrante, valvola flutur DN50, kolektor dergimi, valvola mos-kthimi DN50.		
9	Grupi i furnizimit me uje sanitar me 2 pompa Horizontale ON/OFF te lidhura ne paralel: Prurja = 5.7 m³/h (per secilen pompe); H = 30 m; 3x400V; 5.2 A; Lidhjet: 2"; Kolektore çelik inox/galvanizuar; Ene zgjerimi 25 litra;		
10	Njesi e jashtme-Kompresor inverter VRF (Kompresor me pompe nxehtesie VRF). Kapaciteti ftohes / ngrohjes ne temperaturen 0.0°C : 73 / 81 kw. Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : Ftohje: 19 kw/ Ngrohje: 16.3 kw/ 380-415V / 3 F ~ 50Hz .		

	<i>Pesha 585 kg</i>		
11	<i>Njesi e jashtme-Kompresor inverter VRF (Kompresor me pompe nxehtesie VRF). Kapaciteti ftohës / ngrohës në temperaturën 0.0°C : 106.5 / 119 kw. Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : Ftohje: 42 kw/ Ngrrohje: 29.7 kw/ 380-415V/ 3 F ~ 50Hz . Pesha 745 kg</i>		
12	<i>Njesi Rekuperatore Ajri Volumi i ajrit max : 2950 m³/h Presioni statik 150 Pa Fel.e ventilatoreve 2x0.54 kw 1F~230V,50Hz Kapaciteti termik ftohje: 22.0 kw Kapaciteti termik ngrohje: 25.0 kw Kapaciteti i rekuperimit: 66.9 %</i>		
13	<i>Njesi Rekuperatore Ajri Volumi i ajrit max : 3900 m³/h Presioni statik 150 Pa Fel.e ventilatoreve 2x0.87 kw 1F~230V,50Hz Kapaciteti termik ftohje: 28.0 kw Kapaciteti termik ngrohje:31.5 kw Kapaciteti i rekuperimit: 62.7 %</i>		
14	<i>Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Kanalor, kapaciteti në ftohje/ngrohje 14.00 /16.00 kw, prurja maksimale e ajrit Vmx.=2000 m³/h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz</i>		
15	<i>Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Murale, kapaciteti në ftohje/ngrohje 2.80/3.20 kw, prurja maksimale e ajrit Vmx.=500 m³/h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz.</i>		
16	<i>Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Dysheme, kapaciteti në ftohje/ngrohje 5.00/5.50 kw, prurja maksimale e ajrit Vmx.=680 m³/h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz</i>		

- **Tabela është e detyrueshme për tu plotësuar për të gjithë artikujt e listuar. Mosplotësimi i kësaj tabele është kusht skualifikues.**

2.3.6 Operatorët ekonomikë, **për artikujt/pajisjet e cilësuar në tabelën e mësipërme**, duhet të paraqesin katalogë ose broshura me të dhënat teknike. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre. **Në katalogë do të markohet vetëm një paisje për secilin artikull.**

III.2.2. Në dokumentet e tenderit, si pjesë përbërëse e projektit të zbatimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

-Relacioni teknik në pdf.

-Specifikime teknike në pdf.

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK, rezulton, se ka paraqitur në SPE, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

-Dokumentin me emërtimin EURO_AD__(Q=6.182_H=50.62);

-Dokumentin me emërtimin Deklaratë_për_pajisjet;

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikon se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në

njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.5. Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.2.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në

fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së ankimuar, të administruar pranë KPP, si dhe bazuar në pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se në pikën 2.3.6 të dokumenteve të tenderit si dhe në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar që, *Operatorët ekonomikë, për artikujt/pajisjet e cilësuar në tabelen sipas kriterit në pikën 2.3.5, duhet të paraqesin katalogë ose broshura me të dhënat teknike. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerinë e tyre. Në kataloge do të markohet vetëm një paisje për secilin artikull.* Nga verifikimi i dokumenteve të operatorit ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK, konstatohet, se dokumentet me emërtimin “Deklaratë për pajisjet” dhe “EURO_AD__(Q=6.182_H=50.62)”, të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, janë një deklaratë e ofertuesit për modelin, kompaninë prodhuese, vendimin e prodhimit për mallrat e pajisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së kërkuar në pikën 2.3.5., si dhe katalogun (broshura në gjuhë të huaj angleze), për pajisjen nr.9 Grupi i furnizimit me ujë sanitar me 2 pompa.

Referuar kriterit 2.3.6 dhe 2.3.5., operatorët ekonomikë duhet që për të gjitha pajisjet e listuara në tabelën e kërkuar në pikën 2.3.5, të deklarojnë/paraqesin katalogët ku të evidentohet plotësimi i specifikimeve teknike. Tabela është e detyrueshme për t’u plotësuar për të gjithë artikujt e listuar. Mosplotësimi i kësaj table është kusht skualifikues. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe konkretisht:

Pajisja nr. 9 .Grupi i furnizimit me ujë sanitar me 2 pompa

Horizontale-ON/OFF të lidhura në paralel:

Prurja = 5.7 m³/h (për secilën pompë); H = 30 m;

3x400V; 5.2 A; Lidhjet: 2"; Kolektore çelik

inox/galvanizuar;

Ene zgjerimi 25 litra;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ana e ankimuesit, nuk evidentohet të jetë dorëzuar ndonjë katalog/broshurë/skede teknike mbi enën e zgjerimit 25 litra. Gjithashtu, vetë ankimuesi në formularin e ankesës ka cituar se “*ena e zgjerimit është një pajisje e thjeshtë dhe nuk vendoset në katalogët e pompave pasi për të njëjtin tip pompe, në varësi të konsumit, mund të vendosen enë zgjerimi me kapacitet të ndryshëm*”, duke pranuar vetë, që nuk ka dorëzuar asnjë dokument të llojit katalog/broshurë/skede teknike për enën e zgjerimit 25 litra. Ndërkohë, nga dokumentacioni i paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni konstaton, se nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër provues për plotësimin e këtij kriteri. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor, me të drejtë ka skualifikuar operatorin ekonomik ankimues, pasi dokumenti i paraqitur prej tij, nuk është në përputhje me plotësimin e kriterit 2.3.6 dhe të kërkesave të tabelës në pikën 2.3.5 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Komisioni thekson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni referuar dokumenteve me emërtimin “*Deklaratë për pajisjet*” dhe “*EURO_AD__(Q=6.182_H=50.62)*”, të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, për këtë procedurë prokurimi, gjykon, se nuk mund të konsiderohen se përmbushin kërkesat sipas kriterëve në pikat 2.3.6 dhe 2.3.5, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

III.2.8. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kriteret/specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 110, pika 1 e LPP. Në nenin 110, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet, se “*Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë*”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se, operatorët ekonomikë do të kishin paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, kanë pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75, pika 1 e LPP. Në nenin 75, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet se “*1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator*

ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “AGRI CONSTRUCTION” SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “AGRI CONSTRUCTION” SHPK”, mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit: **“Lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit sqarojmë:** Në pikën 2.3.5. të Kërkesave të veçanta të kualifikimit kërkohet: 2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet që për të gjithë pajisjet e listuara në tabelën e mëposhtme, të deklarojnë/paraqesin katalogët ku të evidentohet plotësimi i specifikimeve teknike...”. Theksojmë se në asnjë rresht nuk është kërkuar që katalogët duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe kjo gjë është krejt normale pasi të dhënat që jepen në katalogë të këtij tipi janë në gjuhë teknike me simbole dhe shifra krejtësisht të kuptueshme nga çdo profesionist. KVO pretendon se, meqenëse gjuha e përdorur është e përcaktuar në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika 4.7 “Gjuha shqipe”, atëherë i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer, i noterizuar në gjuhën shqipe. Komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kuptojë se termat teknik në anglisht tashmë janë aq të përdorura sa që është e pamundur të shmangen. Vetë autoriteti kontraktor në projektet dhe specifikimet e ngarkuara në sistemin elektronik të prokurimit, ndonëse gjuha e dokumentave të tenderit është shqip, ka ngarkuar dokumenta që përmbajnë specifikime anglisht, si psh:

6.5 Pompë e Furnizimit me Ujë Sanitar. Grupi i furnizimit me ujë sanitar me 2 pompa Horizontale ON/OFF të lidhura në paralel: - Prurja = 5.7 m³/h (për secilën pompë); - H = 30 m; - 3x400V; 5.2 A; - Lidhjet: 2"; - Kolektorë çelik inox/galvanizuar; - Enë zgjerimi 25 litra; - Pjesët e pompave në kontakt me ujin: zingato;

6.4 Pompë e Sistemit të Mbrojtjes nga Zjarri Grupi i MNZ sipas EN12845 i përbërë nga 2 Pompa elektrike 2x4.5 kw (1 ne pune + 1 ne stand-by) ku secila jep Q = 4.2 m³/h; H = 35 m; Pompe Pilot "Jockey" 1x0.65 kw, Grupi i MNZ kompletuar me Kit Testimi me Flowmeter, Panel Komandimi dhe Presostate për secilën pompë. Enë zgjerimi 24 lit për pompën pilot. Në dërgim: Xhunto antivibrante - 2 copë, valvola flutur DN50 - 2 copë, kolektor dërgimi DN50, valvola mos-kthimi DN50 - 2 copë.

12.1.1 Access control, të jetë një sistem standart, 230V AC, i pajisur me një panel kontrolli i cilësisë së lartë i cili përmbush të gjitha kërkesat e sistemit të akses kontrollit të avancuar.

13.2.1 Kamerate: Kamerate e brendshme IP Kamerate e brendshme IP përmbajnë një shumëllojshmëri opsionesh të ndryshme. Kamerate janë të pajisur me sensor imazhi Super Low Lux CMOS i cili lejon kamerën të sigurojë një pamje reale me ngjyra në errësirë. Kamera ka një portë për mini USB e cila suporton lidhje wireless nëpërmjet një adaptori wi-Fi (i ndryshëm) ose duke e ruajtur në hapësirë të jashtme duke përsorur një USB të madhe.

14. SISTEMI I KOMUNIKIMIT TE TE DHENAVE I gjithë objekti do të ketë një sistem të mirëllogaritur të komunikimit, me lidhjet me internet nëpërmjet operatorëve që e ofrojnë këtë shërbim. Kështu do të ketë një Rack kryesor i cili do të komunikojnë me Rack-ët në katet e tjera, komunikimi realizohet nëpërmjet fibrës optike të tipit multimode OM3 për gjatësi që nuk e

kalojnë 300 ml dhe singelmode për gjatësi mbi 300 ml që garantojnë transmetimin DWDM (40 e 100 Gps në vetëm një kopje të fibrës optike).

Nisur nga sa më sipër, është e qartë se nuk mund të pranohet pretendimi që operatori ekonomik duhet të përkthejë çdo term në gjuhën shqipe (theksojmë edhe pse nuk është kërkuar shprehimisht në kërkesën për kualifikim) ndërkohë që, ndonëse gjuha e dokumenteve standarte të tenderit është shqip, autoriteti kontraktor ka përdorur masivisht terma anglisht. Ky pretendim absurd i kushton buxhetit të shtetit miliona lekë dëm ekonomik. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

SHTOJCË 1

Për ndryshime të dokumenteve standarde të tenderit me objekt:

"Rikonstruksioni i godines se anatomisë", Universiteti i Mjekesise, Tiranë.

Mbështetur në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 75, si dhe V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, në Dokumentat Standarte të Tenderit me objekt: **"Rikonstruksioni i godines se anatomisë", Universiteti i Mjekesise, Tiranë** me fond limit 80,128,758.52 (tetedhete milion e njeqind e njezet e tete mijë e shtateqind e pesedhete e tete presje pesedhete e dy) leke pa tvsh behen ndryshimet e meposhtme:

2.3.6 Operatorët ekonomikë, për artikujt/pajisjet e cilësuar në tabelen e mesiperme, duhet të paraqesin katalogë ose broshura me të dhënat teknike. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre. Në kataloge do të markohet vetëm një paisje për secilin artikull.

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, rezulton se në sistemin e prokurimeve elektronike, ka paraqitur dokumente me emërtimin sipas listës së mëposhtme, nga verifikimi i të cilave konstatohet, se këto dokumente janë në gjuhë të huaj.

- Dokumentin me emërtimin 1.Centrali_telefonik_datasheet_ucm6208_;
- Dokumentin me emërtimin 2.Central_Alarmi;
- Dokumentin me emërtimin 3.Skeda_dvr;
- Dokumentin me emërtimin 4.Kamera_te_brendsme;
- Dokumentin me emërtimin 5.Kamera_te_jashtme;
- Dokumentin me emërtimin 6.Gjeneratori;
- Dokumentin me emërtimin 7.skeda_UPS_FGCEVDP15TM2;
- Dokumentin me emërtimin 8.KDN_EN_12845_Compact_MNZ;
- Dokumentin me emërtimin 9.2_EURO_AD__(Q=6.182_H=50.62);

- Dokumentin me emërtimin 10_e_11.Njesite_e_jashtme_VRF_Carrier;
- Dokumentin me emërtimin 12_e_13.Rekuperatori_ajrit;
- Dokumentin me emërtimin 14.Njesi_e_brendshme_kanalar_VRF_Carrier;
- Dokumentin me emërtimin 15.Njesi_e_brendshme_Murale_VRF_Carrier;
- Dokumentin me emërtimin 16.Njesi_e_brendshme_Dysheme_VRF_Carrier;

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjisllacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer

shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose

enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.3.4. Në nenin 24 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht: “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”.

Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.3.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në

dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përputhen me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'ua kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.3.6. Në dokumentet e tenderit, Seksioni IV *Procedura*, pika 4.7 është përcaktuar shprehimisht:

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip	X	Anglisht	<input type="checkbox"/>
--------------	----------	-----------------	--------------------------

Gjithshtu, në Shtojcën 7 të dokumentave të tenderit (shtojca -1), “*Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit*”, përcaktohet shprehimisht se: “*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip*”.

III.3.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se katalogët e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes nuk janë paraqitur në gjuhën shqipe, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësimin të specifikimeve teknike sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit, për më tepër që nuk janë të përkthyer të paktën vetëm ato pjesë të katalogut që kanë të bëjnë me përshkrimin apo specifikimet teknike të mallit apo produktit të kërkuar, pasi katalogu nuk përmban vetëm të dhëna teknike (si përmasa etj.), por edhe përshkrim të produktit. Përcaktimi i bërë në dokumentet e tenderit, si në seksionin IV, ashtu edhe në Shtojcën 7 Kriteret e përgjithshme të kualifikimit, aq më tepër në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, përkufizon qartë që gjuha e përdorur është *gjuha shqipe* dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të

huaj duhet të jetë në gjuhën shqipe, ose i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky që vlen për çdo dokument të paraqitur në këtë procedurë prokurimi. Sqarojmë se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithëpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës që paraqitet në këtë procedurë prokurimi.

III.3.8. Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme, të cilat janë detyrimisht për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe detyrimisht për të mos u ndryshuar nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumentave të tenderit, është përcaktuar qartë e saktë që *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”*, si edhe gjuha e përdorur është përcaktuar *“Gjuha Shqipe”*, atëherë i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer i noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky gjithëpërfshirës që i përket çdo lloj dokumentacioni që do të paraqitet në këtë procedurë prokurimi nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Akoma më tej, nisur nga përcaktimi i bërë në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit (tek të cilat autoriteti kontraktor mund të përcaktojë vetë kriteret që mendon se janë të nevojshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë të interesuar, gjithnjë në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, objekt prokurimi), përcaktohet qartë që në Shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit (shtojca -1), *“Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”*, përcaktohet shprehimisht se: *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip*. Ndërkohë që edhe ligjvënësi e ka përcaktuar dhe e ka sqaruar mjaft qartë momentin dhe mënyrën e paraqitjes së dokumentacionit në një procedurë prokurimi, për sa i përket gjuhës së përdorur.

III.3.9. Referuar seksionit II të dokumenteve të tenderit *“Udhëzime për operatorët ekonomikë”* ku përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumente, pasi ankimesi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga

operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis. Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” ShPK në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” ShPK nuk qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK pretendon mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit: “Nuk është paraqitur akti i kolaudimit, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” ku citohet se: “Të gjitha objektet epërkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik...” ku në nenin 3 specifikohet: “Në kuptim të këtij ligji, nëse nuk përcaktohet ndryshe punime ndërtimi quhen të gjitha punimet e ndërtimit për ndërtesat, objektet qytetare, veprat industriale, të infrastrukturës dhe për objektet e tjera.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën -1 të publikur nga APP, shtojcën 7, e ndryshuar, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik” në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1 *Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :*

- a) *dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
- b) *dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- *Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:*
- *Kontratë Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Faturat tatimore;*

- Aktin e kolaudimit;
- Certifikaten e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar.

Shënim : Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore;
 - Akt kolaudimi objekti.
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

III.4.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “PEPA GRUOP” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Formular vlerësimi lëshuar nga investitori “Trema Engineering 2” SHPK për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK për objektin e kontratës “Ndërtim i Godinës së Adminsitratës UKK përfshirë rrethimin dhe sistemimin e hapësirës përreth objektit”, data e fillimit të kontratës 17.05.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 30.04.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxx euro me TVSh, realizuar nga shoqëria “PEPA GROUP” SHPK 95 % të punimeve. Vlerësimi: Shumë Mirë. E përmbushur: Po.
- Kontratë Sipërmarrje datë 08.05.2020 me objekt “Ndërtim i Godinës së Adminsitratës UKK përfshirë rrethimin dhe sistemimin e hapësirës përreth objektit”, ndërmjet investitorit “Trema Engineering 2” SHPK dhe operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, me vlerë xxxxxxxxxxx euro me TVSh.
- Amendim Kontrate datë 18.12.2020 ndërmjet investitori “Trema Engineering 2” SHPK për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK;
- Faturë tatimore shitjeje nr. 158 datë 30.06.2020 (Situacion punimesh nr.1);
- Faturë tatimore shitjeje nr. 201 datë 31.07.2020 (Situacion punimesh nr.2);
- Faturë tatimore shitjeje nr. 180 datë 31.08.2020 (Situacion punimesh nr.3);
- Faturë tatimore shitjeje nr. 192 datë 30.09.2020 (Situacion punimesh nr.4);
- Faturë tatimore shitjeje nr. 69 datë 31.10.2020 (Situacion punimesh nr.5);
- Faturë tatimore shitjeje nr. 82 datë 31.11.2020 (Situacion punimesh nr.6);
- Faturë tatimore shitjeje nr. 58 datë 31.12.2020 (Situacion punimesh nr.7);
- Faturë tatimore shitjeje nr. 86 datë 31.01.2021 (Situacion punimesh nr.8);
- Faturë tatimore shitjeje nr. 33 datë 28.02.2021 (Situacion punimesh nr.9);
- Faturë tatimore shitjeje nr. 81 datë 31.03.2021 (Situacion punimesh nr.10);

- *Faturë tatimore shitjeje nr. 38 datë 30.04.2021 (Situacion punimesh nr.11);*
- *Situacion nr. 11 përfundimtar;*
- *Marrëveshja MIP IV KAMZA SCW 2019 21.02.2020 ndërmjet Ujësellës Kanalizime Kamëz Sha, dhe Strabag AG (përkthyer, noterizuar);*
- *Certifikat e marrjes në dorëzim të një pjesë të punimeve data 28.10.2021(përkthyer, noterizuar);*
- *Marrëveshje nënkontraktimi midis Strabag AG dhe “Trema Engineering 2” SHPK, datë 15.04.2020. me objekt “Ndërtim i Godinës së Adminsitratës UKK përfshirë rrethimin dhe sistemin e hapësirës përreth objektit”, ndërmjet investitorit “Trema Engineering 2” SHPK dhe operatorit ekonomik “Strabag AG”, me vlerë xxxxxxxxxxxx euro me TVSh (përkthyer, noterizuar);*
- *Certifikat e marrjes në dorëzim të një pjesë të punimeve data 11.02.2022 (përkthyer, noterizuar);*

III.4.3. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.4.4. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.4.5. Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i përditësuar (ndryshuar me ligjin nr.3/2020, datë 30.01.2020) në nenin 8, pika 2, i cili parashikon se: “2. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane”

Në nenin 12, parashikohet se: “Procesverbali firmoset nga kolaudatori, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve”,

Udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikqyerjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”,
I ndryshuar me:

- ***Udhëzim i KM Nr.4, datë 17.5.2001***
- ***Udhëzim i KM Nr.7, datë 21.11.2001***
- ***Udhëzim i KM Nr.1, datë 22.2.2005***
- ***Udhëzim i KM Nr.1, datë 16.06.2011***

i përditësuar, Kreu II, pika 7, i cili parashikon se:

II. PËR KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

7. Në përfundim të kolaudimit të veprës, hartohet procesverbali i kolaudimit, i cili firmoset nga kolaudatori ose grupi i kolaudimit, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve. Proceverbali duhet të përmbajë:

a. vendin e ndërtimit;

b. emërtimin e objektit dhe funksionin e tij;

c. datën dhe prejardhjen e projekteve, si dhe ndryshimet e bëra në to;

ç. vlerën e objektit;

d. gjenealitetet e sipërmarrësit;

dh. afatin e ndërtimit;

e. vlerën e shpenzimeve (sipas regjistrave të kontabilitetit);

ë. gjenealitetet e kolaudatorit ose të grupit të kolaudimit dhe specialitetet përkatëse;

f. kohën e zgjatjes së kolaudimit;

g. përshkrimin e verifikimeve të bëra mbi dokumentet dhe faktin, si dhe rezultatet e arritura. Procesverbali paraqitet në dy kopje, në zyrën e urbanistikës dhe, pas regjistrimit një kopje i dërgohet punëdhënësit.

III.4.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konkretisht kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit (të ndryshuar me shtojcën -1 të publikuar nga APP), KPP vëren, se autoriteti kontraktor lidhur me përvojën e mëparshme ka përcaktuar që operatori ekonomik ofertues për plotësimin e këtij kriteri duhet të dorëzojë një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe ku kjo kontratë të jetë realizuar 5 (pesë) vitet e fundit nga data e publikimit të kësaj procedure prokurimi ose duhet të dorëzojë disa punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Në rastin e kontratës ose kontratave të realizuara me **ente publike** dhe ku operatori ekonomik ofertues është palë e kontratës, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin si në vijim: *“Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:Kontratë Sipërmarrje;Situacionin përfundimtar; Faturat tatimore; Aktin e kolaudimit;Certifikaten e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar”*, ndërsa në rastin Për kontrata të realizuara me **sektorin privat** dhe ku operatori ekonomik ofertues është palë e kontratës, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin si në vijim: *“Kontrate Sipërmarrje; Situacionin përfundimtar; Faturat tatimore; Akt kolaudimi objekti.*

Në rastin e kontratës ose kontratave të realizuara me ente publike dhe ku operatori ekonomik ofertues është palë e kontratës si anëtar i një bashkimi operatorësh ekonomikë, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin si në vijim: *“operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE”*.

Ndërsa në rastin e kontratës ose kontratave të realizuara me ente publike dhe ku operatori ekonomik ofertues është nënkontraktor, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin si në vijim: për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor, në ndryshim nga kërkesa në rast se operatori ekonomik ofertues do të ishte anëtar i një bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.4.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin

dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.8. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në këtë kriter kualifikues autoriteti kontraktor në rastin e kontratës ose kontratave të ngjashme ku operatori ekonomik ofertues është anëtar i një bashkimi shoqërie ka përcaktuar që: *“Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE, ndërsa për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor”*. Pra, në dokumentat e tenderit nuk janë parashikuar paraqitja e këtyre dokumentave.

III.4.9. Për plotësimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit të ndryshuar sipas shtojcës -1 të publikuara nga APP, Komisioni, konstaton, se operatori ekonomik ankimues *“PEPA GROUP”* SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentacionin e përmendur në pikën III.4.2. të këtij vendimi. Lidhur me arsyen e skualifikimit Komisioni konstaton, se kontrata e paraqitur datë 08.05.2020 është përvojë e mëparshme e ngjashme e realizuar nga operatori ekonomik ankimues *“PEPA GROUP”* SHPK, ku ky i fundit është në rolin e nënkontraktorit dhe konkretisht nënkontraktor i kompanisë *“Trema Engineering 2”* SHPK me objekt: *“Ndërtim i Godinës së Admistratës UKK përfshirë rrethimin dhe sistemin e hapësirës përreth objektit.”* dhe ku sipas - *Faturë tatimore shitjeje nr. 158 datë 30.06.2020 (Situacion punimesh nr.1);*

- *Faturë tatimore shitjeje nr. 201 datë 31.07.2020 (Situacion punimesh nr.2);*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 180 datë 31.08.2020 (Situacion punimesh nr.3);*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 192 datë 30.09.2020 (Situacion punimesh nr.4);*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 69 datë 31.10.2020 (Situacion punimesh nr.5);*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 82 datë 31.11.2020 (Situacion punimesh nr.6);*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 58 datë 31.12.2020 (Situacion punimesh nr.7);*

- Faturë tatimore shitjeje nr. 86 datë 31.01.2021 (Situacion punimesh nr.8);
- Faturë tatimore shitjeje nr. 33 datë 28.02.2021 (Situacion punimesh nr.9);
- Faturë tatimore shitjeje nr. 81 datë 31.03.2021 (Situacion punimesh nr.10);
- Faturë tatimore shitjeje nr. 38 datë 30.04.2021 (Situacion punimesh nr.11);

Situacion nr. 11 përfundimtar, vërtetohet se ka realizuar punime të ngjashme në vlerën 528,071.04 euro me TVSH.

Për sa i përket përmbushjes së kriterit kualifikues dhe arsyes së skualifikimit, Komisioni gjykon se, kontrata më datë 08.05.2020 plotëson kriterin kualifikues për një kontratë të vetme me vlerë 50%, pasi është më e madhe se 50% e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, është e realizuar brenda 5 viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, si dhe është e shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në kriterin kualifikues të pikës 2.3.1 të shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit dhe konkretisht me *Formular vlerësimi lëshuar nga investitori “Trema Engineering 2” SHPK për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK për objektin e kontratës “Ndërtim i Godinës së Admnsitratës UKK përfshirë rrethimin dhe sistemimin e hapësirës përreth objektit”, data e fillimit të kontratës 17.05.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 30.04.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxxxxxx euro me TVSh, realizuar nga shoqëria “PEPA GROUP” SHPK 95 % të punimeve. Vlerësimi: Shumë Mirë. E përmbushur: Po.*

-*Kontratë Sipërmarrje datë 08.05.2020 me objekt “Ndërtim i Godinës së Admnsitratës UKK përfshirë rrethimin dhe sistemimin e hapësirës përreth objektit”, ndërmjet investitorit “Trema Engineering 2” SHPK dhe operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, me vlerë xxxxxxxxxxxx euro me TVSh.*

-*Amendim Kontrate datë 18.12.2020 ndërmjet investitori “Trema Engineering 2” SHPK për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK;*

-*Fatura tatimore shitjeje + situacion përfundimtar.*

Për më tepër Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues “PEPA GROUP” SHPK ka dorëzuar edhe dokumentacion shtesë si në vijim:

- *Marrëveshja MIP IV KAMZA SCW 2019 21.02.2020 ndërmjet Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sha, dhe Strabag AG (përkthyer, noterizuar);*
- *Certifikat e marrjes në dorëzim të një pjesë të punimeve data 28.10.2021(përkthyer, noterizuar);*
- *Marrëveshje nënkontraktimi midis Strabag AG dhe “Trema Engineering 2” SHPK, datë 15.04.2020. me objekt “Ndërtim i Godinës së Admnsitratës UKK përfshirë rrethimin dhe sistemimin e hapësirës përreth objektit”, ndërmjet investitorit “Trema Engineering 2” SHPK dhe operatorit ekonomik “Strabag AG”, me vlerë xxxxxxxxxxxx euro me TVSh (përkthyer, noterizuar);*
- *Certifikate e marrjes në dorëzim të një pjesë të punimeve data 11.02.2022 (përkthyer, noterizuar);* dokumentacion i cili vërteton, se nënkontraktori “PEPA GROUP” SHPK ka realizuar me sukses kontratën datë 08.05.2020 në vlerën 528,071.04 euro me TVSH dhe afatin e përcaktuar, vërtetuar kjo me situacionin përfundimtar dhe faturat tatimore shitjeje sipas muajve respektiv.

III.4.10. Sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë

të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara, pasi operatori ekonomik ankimues “PEPA GROUP” SHPK ka paraqitur kontratë të ngjashme ku është nënkontraktor. Kjo kontratë është e shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve të tenderit, të ndryshuar sipas shtojcës -1 të publikuar në sistemin e prokurimit elektronik.

Gjithashtu, nga përlllogaritja e vlerës së punëve të ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, duke e përlllogaritur sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në kontratën e paraqitur (të nëkontraktimi), vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik, e tejkalon vlerën për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Akoma më tej, në kuptim të ligjit sektorial, subjekti privat (*sipërmarrësi/zbatuesi i punimeve/"Kontraktori" do të thotë operatori (ët) ekonomik/ë që do të realizojë/në punimet objekt kontrate*), i cili është i licensuar sipas legjislacionit të ndërtimit, për të kryer punime ndërtimore në zbatim, si edhe fitues i kontratës së prokuruar nga një autoriteti/ent publik. Në këto kushte, palët lidhin dhe nënshkruajnë një kontratë midis tyre, pra kemi një marrëdhënie kontraktuale, me qëllim zbatimin e kontratës, për realizimin e zbatimit të punimeve të ndërtimit. Në interpretim të legjislacionit sektorial, të zbatimit të disiplinimit të punimeve të ndërtimit, sipërmarrësi ose zbatuesi i punimeve, (*"Kontraktori" do të thotë operatori (ët) ekonomik/ë që do të realizojë/në punimet objekt kontrate*), është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, i cili është akti i lejimit të punimeve për zhvillimin e tokës ose të strukturës në të. Leja e ndërtimit i jepet kërkuesit të saj, në bazë të një kërkesë të veçantë. Ndërsa, në përfundim të kolaudimit të veprës, hartohet proces-verbali i kolaudimit, i cili firmoset nga kolaudatori ose grupi i kolaudimit, sipërmarrësi ose zbatuesi i punimeve, ("Kontraktori" do të thotë operatori (ët) ekonomik/ë që do të realizojë/në punimet objekt kontrate), dhe mbikëqyrësi i punimeve/supervizori.

Pra, sa më sipër, akt-kolaudimi nënshkruhet nga sipërmarrësi i punimeve (kontraktori kryesor), i cili ka një marrëdhënie kontraktuale me një autoriteti/ent publik, për realizimin e zbatimit të punimeve të ndërtimit. Ndërsa, "Nënkontraktor" do të thotë, çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për ofrimin e një pjese të punëve ose shërbimeve të lidhura me to, i cili pajiset me akt-kolaudimin, duke e marrë këtë dokument, nga sipërmarrësi i parë i punimeve të zbatimit të ndërtimit, ku ky i fundit ka një marrëdhënie kontraktuale me një autoriteti/ent publik, për të cilin ka fituar një kontratë publike për zbatimin e punimeve. Gjatë kolaudimit bëhet shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit dhe provat e nevojshme për të vërtetuar kërkesat e projektit, kontratës dhe dispozitave të tjera në fuqi dhe në përfundim lëshohet certifikata e kolaudimit.

Në rastin në fjalë, operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, është në rolin e nënkontraktorit, për të realizuar një pjesë të punimeve, i cili ka lidhur një marrëveshje nënkontraktimi me subjektin/ent privat “Trema Engineering 2” SHPK, dhe ky i fundit vetë është në rolin e nënkontraktorit, i cili ka rënë dakort me kontraktorin kryesor për të ekzekutuar punët e nënkontraktorit, të caktuara për kontraktorin kryesor. Pra, akt kolaudimi, në zbatim të

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i përditësuar (ndryshuar me ligjin nr.3/2020, datë 30.01.2020) dhe Udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikqyerjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, nuk nënshkruhet dhe as nuk është palë në këtë proces nënkontraktori i nënkontraktorit të punimeve. Në rastin konkret, marrëveshja e nënkontraktimit e operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK me subjektin/ent privat “Trema Engineering 2” SHPK, është një marrëveshje nënkontratë me ent privat, si dhe referuar kriterit të sipërcituar, për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor. Por Komisioni sqaron, se referuar informacionit të administruar në dosje, për kontratën si punë të ngjashme të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, burimet e financimit (për ndërtimin e godinës administrative UKK), janë nga institucione ndërkombëtare dhe banka shumëpalëshe për zhvillim, dhe Ujësjetës Kanalizime Kamës nuk ka qenë autoritet kontraktor në atë procedurë prokurimi, pra operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK nuk ka se si të paraqesë ndonjë dokument me emërtimin “miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor”.

III.4.11. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “PEPA GROUP” SHPK, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme, është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kontrata e nënkontraktimit e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së mëparshme të ngjashme ku ofertuesi në kontratën e ngjashme është në rolin e nënkontraktorit. Akoma më tej, autoriteti kontraktor ka pasur mundësinë që t’i kërkojë sqarime ofertuesit referuar nenit 82 pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “PEPA GROUP” ShPK qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “INERTT” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se:

“Për paisjen Nr. 5 Gjenerator Diesel

Në katalogun e paraqitur nuk specifikohet modeli i caktuar dhe kjo pajisje nuk plotëson pikën 2.3.6 të DST-së. Janë paraqitur disa modele që nuk i përkasin firmës që ka deklaruar si prodhuese. Firma e deklaruar është kompani Shqiptare e cila mund ti tregëtojë këto pajisje. Nuk është paraqitur katalogu origjinal i prodhuesit.

Për paisjen Nr. 8 është kërkuar Grupi MNZ:

- Tek kjo paisje janë paraqitur vetëm specifikimet për pompat por pa specifikuar mënyrën e vendosjes apo pozicionimin që zënë këto pompa në Grupin MNZ. Meqënëse në katalog janë

paraqitur elementët veç e veç këtu mungojnë element të Grupit MNZ si Paneli Komandimit dhe presostate për secilën pompë; si dhe Enët e zgjerimit;

- Mungon Enë zgjerimi 24 litra për pompën pilot;
- Mungon Xhunto antivibrant;
- Mungon Valvola flutur DN50;
- Mungon Kolektori dërgimit;
- Mungon Valvola mos-kthimit DN50 është paraqitur DN40;
- Është e paqartë mënyra si do të lidhen këto dy pompa, pasi dhe valvulat i kanë në dimensione të ndryshme. Pompa cetrifugale ka një valvul më të madhe se pompa vertikale, e cila mund të çojë në shpërthimin e pompës vertikale për shkak të prurjes më të madhe se ajo vertikale.

Për pajisjen Nr. 9 është kërkuar Grupi i furnizimit me ujë sanitar:

Tek kjo paisje janë paraqitur në katalog specifikimet për pompën e ujit ku nuk plotësohet specifikimi teknik për:

- Për pompën SD90 në tabelë janë 4 tipe dhe nuk është markuar modeli të cilit i referohet operatori;
- Mungojnë lidhjet 2" e cila konvertohet me 63mm nuk plotësohet ky specifikim;
- Mungon specifikimi për enën e zgjerimit 25 litra që nuk është paraqitur fare në katalog;
- Nuk plotëson kapacitetin 400V pasi operatori ekonomik e ka paraqitur 220V – 380V.

Për pajisjen Nr. 12 dhe Nr. 13

Tek këto pajisje nuk përcaktohet se cili model UTH3 është sipas katalogut të paraqitur dhe cili model UTH4 është sipas katalogut. Tipi i pajisjes nuk është i markuar si model dhe është e vështirë të kuptohen specifikimet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7/2, të modifikuar tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet që për të gjitha pajisjet e listuar në tabelën e mëposhtme, të deklarojnë/paraqesin kataloget ku te evidentohet plotësimi i specifikimeve teknike:

Nr.	Emërtimi i pajisjes	Specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve dhe nr. i faqes se katalogëve për çdo artikull/pajisje etj.	Kompania prodhuese, Ëeb, E-mail, Nr. kontakti
6	Gjenerator diesel S = 45 kVA / , Un =400V, silencioze, deri 60db per 7m, komplet me kuadrin automatik dhe gjithcka		

	<i>te nevojshme sipas standartit.</i>		
8	<p>Grupi i MNZ sipas EN12845 i perbere nga 2 Pompa elektrike 2x4.5 kkw (1 ne pune + 1 ne stand-by)</p> <p>ku secila jep: $Q=4.2 \text{ m}^3/\text{h}$; $H=35 \text{ mkH}_2\text{O}$;</p> <p>Pompe Pilot "Jockey" 1x0.65 kw, Hydro EN-S2 32-200/219 - 98925936 Grupi i MNZ kompletuar me Panel Komandimi dhe Presostate per secilen pompe.</p> <p>Ene zgjerimi 24 lit per pompen pilot.</p> <p>Xhunto antivibrante, valvola flutur DN50, kolektor dergimi, valvola mos-kthimi DN50.</p>		
9	<p>Grupi i furnizimit me uje sanitar me 2 pompa Horizontale ON/OFF te lidhura ne paralel:</p> <p>Prurja = $5.7 \text{ m}^3/\text{h}$ (per secilen pompe); $H = 30 \text{ m}$;</p> <p>3x400V; 5.2 A; Lidhjet: 2"; Kolektore çelik inox/galvanizuar;</p> <p>Ene zgjerimi 25 litra;</p>		
12	<p>Njesi Rekuperatore Ajri</p> <p>Volumi i ajrit max : $2950 \text{ m}^3/\text{h}$ Presioni statik 150 Pa</p> <p>Fel.e vetilatoreve 2x0.54 kw 1F~230V,50Hz</p> <p>Kapaciteti termik ftohje: 22.0 kw</p> <p>Kapaciteti termik ngrohje: 25.0 kw</p> <p>Kapaciteti i rekuperimit: 66.9 %</p>		
13	<p>Njesi Rekuperatore Ajri</p> <p>Volumi i ajrit max : $3900 \text{ m}^3/\text{h}$ Presioni statik 150 Pa</p> <p>Fel.e vetilatoreve 2x0.87 kw 1F~230V,50Hz</p> <p>Kapaciteti termik ftohje: 28.0 kw</p> <p>Kapaciteti termik ngrohje:31.5 kw</p> <p>Kapaciteti i rekuperimit: 62.7 %</p>		

- Tabela është e detyrueshme për tu plotësuar për të gjithë artikujt e listuar. Mosplotësimi i kësaj tabele është kusht skualifikues.

2.3.6 Operatorët ekonomikë, për artikujt/pajisjet e cilësuar në tabelen e mesiperme, duhet të paraqesin katalogë ose broshura me të dhënat teknike. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të permbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre. Në kataloge do të markohet vetëm një paisje për secilin artikull.

III.5.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "INERTP" SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

-Dokumenti me emërtimin *Inerti_Autorizimet_Mjeksia.pdf*;

III.5.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.5.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.5.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranohet dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.5.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.5.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
- c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.5.8. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr. 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

III.5.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.5.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me

kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.5.11. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit sa më cilësor, me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, KPP vëren, se operatori ekonomik në lidhje me dokumentin me emërtimin *Inerti_Autorizimet_Mjeksia pdf*, pretendon se:

? *Autoriteti Kontraktor gjykon se: **Për paisjen Nr. 5 Gjenerator Diesel.** Në katalogun e paraqitur nuk specifikohet modeli i caktuar dhe kjo pajisje nuk plotëson pikën 2.3.6 të DST-së. Janë paraqitur disa modele që nuk i përkasin firmës që ka deklaruar si prodhuese. Firma e deklaruar është kompani Shqiptare e cila mund ti tregëtojë këto pajisje. Sqarojmë që për paisjen Gjenerator Diesel, nga autoriteti kontraktor nuk është kërkuar asnjë model i caktuar. Është kërkuar thjesht paraqitja e katalogut për Gjenerator diesel $S = 45 \text{ kVA} / , Un = 400V$, silencioze, deri 60db për 7m, komplet me kuadrin automatik dhe gjithçka të nevojshme sipas standartit. Duke qenë se këto produkte nuk kanë një distributor zyrtar pasi kanë marrëveshje me disa tregtar ku një ndër to është dhe Fredi Gjenerator nga faqja zyrtare e e të cilit janë marrë dhe këto materiale, atëhere kemi deklaruar këtë të fundit në shtojcë. Në katalog pasqyrohet qartë fuqia e kërkuar e gjeneratorëve me të dhënat respektive për secilin nga modelet. Sqarojmë se, të gjitha katalogjet e deklaruar janë të një formati zyrtar, të dërguar nga kompanitë prodhuese duke na i vënë në dispozicion me anë të distributorit të autorizuar. Këto katalogje janë të një formati standart dhe nuk mund të modifikohen apo përshtaten kërkesave për procedura të ndryshme pasi kemi të bëjmë me katalogje të cilat dalin nga prodhuesi në nivel ndërkombëtar për mallin që prodhojnë.*

Nëse Autoriteti Kontraktor kërkon informacion më specifik, i cili si e shpjeguar më lart nuk paraqitet në katalogjet që kanë format standart, mund të kërkonte informacion në çdo kohë sipas pikës 7 të nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: "Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, ndërsa në pikën 2 të nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet se "Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës".

? ***Për paisjen Nr. 8 është kërkuar Grupi MNZ:** - Tek kjo pajisje janë paraqitur vetëm specifikimet për pompat por pa specifikuar mënyrën e vendosjes apo pozicionimin që kanë këto pompa në Grupin MNZ. Meqënëse në katalog janë paraqitur elementët veç e veç këtu mungojnë element të Grupit MNZ si Paneli Komandimit dhe presostate për secilën pompë; si dhe Enët e zgjerimit; - Mungon Enë zgjerimi 24 litra për pompën pilot; - Mungon Xhunto antivibrant,*

Mungon Valvola flutur DNS50; - Mungon Kolektori dërgimit; - Mungon Valvola mos-kthimit DNS00 është paragitur DN40; - Është e paqartë mënyra si do të lidhen këto dy pompa, pasi dhe valvulat janë në dimensione të ndryshme. Pompa cetrifugale ka një valvul më të madhe se pompa vertikale, e cila mund të cojë në shpërthimin e pompës vertikale për shkak të prurjes më të madhe se ajo vertikale.

Dhe në rastin konkret jemi përballë të njëjtij fakt dhe ritheksojmë që të gjitha katalogjet e deklaruar, ndër to dhe katalogjet për pompat, janë të një formati zyrtar, të dërguar nga kompanitë prodhuese duke na i vënë në dispozicion me anë të distributorit të autorizuar. Këto katalogje janë të një formati standart dhe nuk mund të modifikohen apo përshtaten kërkesave për procedura të ndryshme pasi kemi të bëjmë me katalogje të cilat dalin nga prodhuesi në nivel ndërkombëtar për mallin që prodhojnë.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 1, thuhet se: “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Duket qartazi tendenca për të skualifikuar padrejtësisht një subjekt që plotëson çdo element kryesor të kapacitetit financiar dhe teknik, me një eksperiencë 33 vjeçare që operon në tregun shqiptar. Ak nuk mund të paragjykoj si difektoze një brand global të prodhimit të pompave në formën e lidhjes së valvulave duke shfaqur paqartësi dhe gjykime apriori me arsyetime qesharake që pompa mund të shpërthejë pasi çdo kompani bën analiza dhe prova para se të hedhi një produkt në treg.

Për sa më sipër, në katalog janë paraqitur elementët më të rëndësishëm përbërës të këtyre pompave. Nëse autoriteti kontraktor kërkon informacion më specifik, i cili si e shpjeguar më lart nuk paraqitet në katalogjet që kanë format standart, mund të kërkonte informacion në çdo kohë sipas pikës 7 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”, ndërsa në pikën 2 të nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se “Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës”

? Për pajisjen Nr. 9 është kërkuar Grupi i furnizimit me ujë sanitar: Tek kjo paisje janë paraqitur në katalog specifikimet për pompën e ujit ku nuk plotësohet specifikimi teknik për: - Për pompën SD30 në tabelë janë 4 tipe dhe nuk është markuar modeli të cilit i referohet operatori; - Mungojnë lidhjet 2 e cila konvertohet me 63mm nuk plotësohet ky specifikim; - Mungon specifikimi për enën e zgjerimit 25 litra që nuk është paraqitur fare në katalog; - Nuk plotëson kapacitetin 400V pasi operatori ekonomik e ka paraqitur 220V - 380V.

Në katalogjet e ngarkuar në DST nuk është vetëm një model pompe por janë disa modele pompash të cilat megjithëse nuk kanë kapacitetin 400 V, nga ana mekanike janë të njëjta duke arritur të njëjtin funksionalitet të kërkuar nga Ak. Këto katalogje janë dorëzuar në bashkëpunim me ekspert të fushës të cilët na kanë siguruar që këto produkte kanë të njëjtin

funksionalitet gjë që plotëson kushtet dhe specifikimet teknike që keni kërkuar ju si institucion. Ne shtojcë është deklaruar dhe faqja zyrtare e distributorit të autorizuar për çdo produkt duke i dhënë mundësinë AK të verifikojë këto të dhënat dhe të shohi gamën e gjerë të produkteve që këto disponojnë pasi si theksuam më sipër jo çdo produkt disponon katalog me specifikimet e kërkuara. Autoriteti kontraktor, me anë të informacionit që i kemi vënë në dispozicion në shtojcën e kërkuar prej tyre, mund të kontrakttoj lehtësisht me këta distributorë për të konfirmuar disponimin dhe testimin e këtyre produkteve edhe fizikisht nëse do jetë e nevojshme. **? Për pajisjen Nr. 12 dhe Nr. 13** Tek këto pajisje nuk përcaktohet se cili model UTH3 është sipas katalogut të paragitur dhe cili model UTH4 është sipas katalogut. Tipi i pajisjes nuk është i markuar si model dhe është e vështirë të kuptohen specifikimet.

Fakti që autoriteti kontraktor nuk arrin të dalloj në katalog element të materialeve të kërkuara nuk duhet të konsiderohet kusht për skualifikim pasi këto katalogje janë paraqitur sipas kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe ky i fundit në çdo kohë mund të kërkoj informacion sqarues sipas pikës 7 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”., ndërsa në pikën 2 të nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se “Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës”.

Për shkak të specifikës së procedurës së prokurimit dhe nivelit të ekspertizës së saj, përpara vijimit me hapa të tjerë procedurale, KPP ka vendosur të thërrasë në këtë seancë dëgjimore autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik ankimues në lidhje me sqarimin e fakteve dhe rrethanave të ankesës së operatorit ekonomik dhe dëgjimit të autoriteti kontraktor. Konkretisht nga ana e Komisionit, pasi u shqyrtua ankesa e ankimuesit është konstatuar, se pretendimet që ngre operatori ekonomik janë në dokumentin me emërtimin “*Inerti_Autorizimet_Mjeksia pdf*”, të ngarkuar nga ky i fundit në sistemin e prokurimeve elektronike. Në lidhje me këto pretendime, KPP i ftoi palët në procesin administrativ me nr. 487 prot, duke zhvilluar një seancë dëgjimore me datë 05.04.2024. Komisioni iu drejtua palëve në këtë seancë nëse ka kërkesa paraprake prej tyre, dhe nuk pati asnjë kërkesë paraprake nga ana e tyre.

Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, Komisioni iu drejtua operatorit ekonomik “INERTI” SHPK, si dhe autoritetit kontraktor, konkretisht ekspertëve të fushës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi mënyrën e përmbushjes së këtij kriteri.

1.- Pyetje drejtuar operatorit ekonomik “INERTI” SHPK: “Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj si subjekt ankimues, konkretisht:

- **Për pajisjen Nr. 6 Gjenerator Diesel**

të na tregoni se, në cilën faqe të katalogëve respektivë të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (INERTI_AUTORIZIME_MJEKSIA), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?

Përgjigja e OE: “Prodhuesi është Volvo dhe është paraqitur katalogu i Fredi Gjenerator, i cili është distributori i autorizuar i kësaj kompanie, duke qenë se kompanie Volvo është kompani ndërkombëtare, e kanë shumë të vështirë të japin autorizime për një produkt, dhe prandaj është deklaruar Fredi Gjenerator, si faqe zyrtare dhe emrin e kompanisë prodhuese që është Volvo. Këto të dhëna deklarohen në faqen 54-56 të materialit pdf të dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike. Duke qenë se është kërkuara që gjeneratori të jetë diesel 40Wat, dmth është 3 fazor. Në faqen 11 ose 56 të katalogut kemi paraqitur të gjithë gjeneratorët që janë 3 fazor dhe mbi 400 ëat. Ne kemi paraqitur disa lloje gjeneratorësh, se pse jemi të autorizuar nga distributori zyrtar që të blejmë të gjithë këto gjeneratorë, dkush mun dtë ketë edhe kapacitet më të lartë por kjo nga ana teknike nuk përbën asnjë problem, se qëllimi realizohet, kryesoria është të dimë qëllimin e autoritetit kontraktor pse i ka vendsour këto kritere, pasi një operator ekonomik shfaq pajisje që kanë një kapacitet më të lartë duhet të skualifikohet.

Nga ana teknike, gjeneratorët që janë paraqitur, nga ana teknike janë shumë të sakta. Thjeshtë është kërkuar nga autoriteti, të jetë 3 fazor, të jetë diesel dhe të jetë më këtë fuqi, 45 Kë, pra ne kemi ofruar një gjenerator me një fuqi akoma më të madhe se sa 45 Kë, që i përmbush të treja këto pika, që autoriteti pretendon se nuk qëndrojnë.

Pyetje drejtuar Autoritetit Kontraktor: “Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj, mbi vlerësimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për përmbushjen e specifikimit teknik të kërkuar në dokumentat e tenderit, **për artikullin me nr. 6 Gjenerator Diesel?** A janë kërkuara sqarime nga ana e KVO, në bazë të nenit 82 vijues, të VKM nr. 285 sqarime nga operatorët ekonomike pjesëmarrës apo operatori ekonomik ankimues, mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, në lidhje me këtë çështje?

Përgjigja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): “Atëherë pika 2.3.6 thotë që këto duhet të jenë të markuara, duhet të jenë katalog origjinal, për pjesën e prodhuesit flas, nëse është Volvo, duhet të vijë katalog nga Volvo, dhe nuk jo nga një firmë shqiptare, dmth katalogu duhet të jetë origjinal nga prodhuesi. Përveç se kësaj, ato janë 4 gjenerator, që nuk dihte se kush është ai që do të paraqitet në zbatim, operatori ekonomik ka të drejtë që njërin nga këta, të ma sjelli, dhe atë që nuk plotëson kriterin sepse janë 4 variante, dhe ka të drejtë se ato ka paraqitur në këtë procedurë dhe me këtë vjen. Ti nuk më ke thënë, që ky varianti nuk i plotëson, sepse duke i paraqitur të 4 variantet dhe të pa markuar, pa specifikuar se kush është, ai mund të më sjelli një nga variantet e tij dhe gjatë zbatimit mund të më dali një problem. Një gjë është që ai nuk e plotëson kapacitetin për ta mbuluar fuqin që ka, sepse variantet nuk janë të 4 njësoj, dhe këtu un duhet të aludoj se kush është varianti që operatori ka dashur të tregojë. Dhe firma është ajo që nuk e prodhon. Të gjithë kataloget kanë ardhur nga firmat përkatëse dhe jo nga Fredi gjenerator që është një kompani shqiptare.

Pyetje drejtuar Autoritetit Kontraktor: “Është vlerësuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, se cili nga variantet nuk përmbush specifikimet teknike?”

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): “ Vetëm një i përmbush specifikimet teknike, që është mbi 400Volt, njëri është shumë i madh, nuk kërkohet me aq kapacitet, dmth dy i përmbushin specifikimet teknike, kurse dy nuk i plotësojnë specifikat, që mund të mi sjelli nja nga këta të dy gjatë zbatimit.

Përgjigjja e OE: “Nuk është kërkuar në DST një dokument që të vërtetojë lidhjen ndërmjet distributorit dhe prodhuesit. Në momentin që do të sillnim dokumente në fazën e dytë, mund tju vërtetonim që Fredi Gjenerator distributori zyrtar i Volvos.

Për sa u diskutua në këtë seancë dëgjimore, Komisioni sqaron, se në lidhje me pretendimin e parë të ankimesit, për paraqitjen e disa varianteve për pajisjen nr. 6 Gjenerator Diesel, në seksionin 2 “Objekti i Kontratës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.15 Pranohen variantet:

Po



Jo

X

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, që specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet

kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”. Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të

tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.” KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Pra KPP thekson, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se nuk do të pranohen variantet. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik ka detyrimin të dorëzojë në cilësinë e pajisjes vetëm një model/variant sipas specifikimeve/karakteristikave të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Në kuptim dhe në zbatimin të parimit të barazisë në trajtimin e kandidatëve/ofertuesve, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit duhet të tregojë kujdes që të përcaktojë të njëjtat të drejta dhe detyrime në radhët e pjesëmarrësve. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e një model/variant sipas specifikimeve/karakteristikave nuk krijon konfuzion tek ofertuesit në plotësimin e kërkesës: KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, ndërsa ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin e ankimuesit mbi arsyen e skualifikimit të bërë nga ana e autoritetit kontraktor, mbi dorëzimin e katalogut origjinal të prodhuesit, Komisioni sqaron se, referuar hartimit të kriterit dhe përmbushjes së ij, është kërkuar vetëm paraqitja e katalogëve ose broshurave me të dhënat teknike sipas specifikimeve të vendosura dhe asnjë informacion tjetër për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se skualifikimi operatorit ekonomik ofertues është bërë duke iu referuar një kriteri kualifikues të pakërkuar, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimin publik. KPP gjykon, se nëse autoriteti kontraktor do të kishte paqartësi në vlerësimin për përmbushjen e këtij kriteri, në kuptim të pikës 1, të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve. Si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit

ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, Komisioni iu drejtua operatorit ekonomik "INERTI" SHPK, si dhe autoritetit kontraktor, konkretisht ekspertëve të fushës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi mënyrën e përmbushjes së këtij kriteri, për pajisjen nr. 8 Grupi MNZ.

2.- Pyetje drejtuar operatorit ekonomik "INERTI" SHPK: "Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj si subjekt ankimues, konkretisht:

- ***Për pajisjen Nr. 8 është kërkuar Grupi MNZ***

të na tregoni se, në cilën faqe të katalogëve respektivë të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (INERTI_AUTORIZIME_MJEKSIA), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?

Pyetje drejtuar autoritetit kontraktor: "Është kërkuar ofertë teknike nga ana e autoritetit kontraktor në këtë procedurë prokurimi? Janë kërkuar vetëm katalogë për pajisjet apo edhe skemat lidhëse dhe mënyrë se si do të vendosen këto pajisje?"

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): "Janë të gjitha në projekt. Dhe projekti është i gjithi në sistem. Ne kemi kërkuar sistem, grup, pasi i gjithë është grup MNZ".

Përgjigjja e OE: "Pompat vijnë paket, kurse të tjerat janë pjesë plotësuese edhe i ke në preventiv.

Këto janë katalogë ndërkombëtar, që vijnë nga Starpompa, dhe nuk mund të pretendojmë që çdo element që pretendohet nga autoriteti kontraktor të pasqyrohet në atë katalog. Në cdo kohë mund të na kërkonit sqarime. Elementët plotësues nuk janë të pasqyruar në katalog pasi janë element suplementar, plotësues dhe nuk janë në katalog. Për sa i përket pretendimit të AK, janë disa lloje enë zgjerimi, që kur blihet kjo lloj pompe vjen bashke me enën e zgjerimit.

Si dhe në deklataën për pajisjet, është faqia zyrtare e prodhuesit ku AK mund ti referohet për çdo paqartësi që mund të ketë.

Pyetje drejtuar autoritetit kontraktor: "Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj, mbi vlerësimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për përmbushjen e specifikimit teknik të kërkuar në dokumentat e tenderit, për artikullin me nr. 8 Grupi MNZ?"

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): "Sqarimi që jep operatori është për pajisjen nr. 9 dhe për pajisjen e grupit të MNZ dhe jo nr.8. Katalogët e paraqitur për pajisjen nr. 8 nuk pasyrojnë skemën lidhëse të dy pompave dhe nuk ka pasqyruar asnjë aksesori plotësues si ena e zgjerimit. Tek pjesa e përkthyer e specifikime teknik nuk është cituar asnjë vend se ku është ena e zgjerimit, apo as që nuk i mungon xhunto.

Për sa u diskutua në këtë seancë dëgjimore, Komisioni sqaron, se në lidhje me pretendimin e

parë të ankimuesit, mbi mosspecifikimin nga ana e ofertuesit për mënyrën e vendosjes apo pozicionimit që zënë këto pompa në Grupin MNZ, si edhe paqartësi mbi mënyrën se si do të lidhen këto dy pompa, Komisioni sqaron, se duke iu referuar hartimit dhe përmbushjes së kriterit, autoriteti kontraktor për rastin konkret, nuk ka kërkuar asnjë skemë lidhëse mbi vendosjen apo pozicionimin që zënë këto pompa në Grupin MNZ. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se skualifikimi operatorit ekonomik ofertues është bërë duke iu referuar një kriteri kualifikues të pakërkuar, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimin publik. KPP gjykon, se nëse autoriteti kontraktor do të kishte paqartësi në vlerësimin për përmbushjen e këtij kriteri, në kuptim të pikës 1, të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve, si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin mbi mungesën e elementeve plotësuese të këtyre pompave (*enë zgjerimi 24 lit për pompën pilot; xhunto antivibrant; valvola flutur DN 50; Kolektor dërgimi, valvol mos-kthimi DN 50*), pra mosparaqitja e tyre në katalog, Komisioni sqaron, se në hartimin dhe përmbushjen e këtij kriteri, autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme paraqitjen edhe të elementëve plotësues të këtyre pompave të Grupit MNZ. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje të operatorit ekonomik, se ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesave mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, parashikuar nga neni 110 pika 1 e LPP. Konkretisht në nenin 110, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Rezulton se ankimuesi është njohur me dokumentet e tenderit në datën e publikimit të njoftimit të kontratës dhe afatet e ankimit për dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi për ankimuesin, nisin nga dita e publikimit të tyre dhe mbarojnë në ditën e shtatë sipas parashikimit ligjor në nenin 110, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Operatori ekonomik është palë e interesuar në përmbushje të të gjitha kërkesave të DST, me qëllim fitimin e kontratës, ndaj ofertimi i mallrave në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim është i rëndësishëm. KPP thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit

të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Komisioni gjykon, se bazuar në dokumentacionin e dosjes administrative, është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë operatorët ekonomikë i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, Komisioni iu drejtua operatorit ekonomik “INERTI” SHPK, si dhe autoritetit kontraktor, konkretisht ekspertëve të fushës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi mënyrën e përmbushjes së këtij kriteri, për pajisjen nr. 9 Grupi i furnizimit me ujë sanitar.

3.- Pyetje drejtuar operatorit ekonomik “INERTI” SHPK: “Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj si subjekt ankimues, konkretisht:

• **Për pajisjen Nr. 9 është kërkuar Grupi i furnizimit me ujë sanitar,**
të na tregoni se, në cilën faqe të katalogëve respektivë të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (INERTI_AUTORIZIME_MJEKSIA), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?

Përgjigjja e OE: “Ky produkt gjendet në faqen 121 të dokumentit pdf të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik. Për enen e zgjerimit kemi të njëjtën analogji si rast më përpara, që janë elementë që vijën paket.

Pyetje drejtuar autoritetit kontraktor: “Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj, mbi vlerësimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për përmbushjen e specifikimit teknik të kërkuar në dokumentet e tenderit, për artikullin me nr. 9 Grupi i furnizimit me ujë sanitar?”

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): “Nuk plotëson kapacitetin 400vat, nuk ke të specifikuar ku është ena e zgjerimit, as lidhja 2 “. Janë paraqitur 4 tipe pompash SD 90, dhe nuk ka markuar asnjërin dhe është e njëjta situatë si tek gjeneratorët. Ena e zgjerimit mungon në katalog. Për kriterin 2 “dhe 400 volt, nuk e përmbush asnjëri nga variantet e dorëzuara nga operatori ekonomik”.

Në lidhje me pretendim e ankimuesit, për arsyen e skualifikimit për pompën SD90 ku në katalog janë paraqitur 4 tipe dhe nuk është markuar modeli të cilit i referohet operatori, Komisioni sqaron, se në seksionin 2 “Objekti i Kontratës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.15 Pranohen variantet:

Po



Jo

X

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve

teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, që specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të

barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”. Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.” KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Pra KPP thekson, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se nuk do të pranohen variantet. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik ka detyrimin të dorëzojë në cilësinë e pajisjes vetëm një model/variant sipas specifikimeve/karakteristikave të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Në kuptim dhe në zbatim të parimit të barazisë në trajtimin e kandidatëve/ofertuesve, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, duhet të tregojë kujdes që të përcaktojë të njëjtat të drejta dhe detyrime në radhët e pjesëmarrësve. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e një model/variant sipas specifikimeve/karakteristikave nuk krijon konfuzion tek ofertuesit në plotësimin e kërkesës: KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, ndërsa ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin mbi mungesën e elementeve plotësuese të Pajisjes nr. 9 Grupit të furnizimit me ujë sanitar (*lidhja 2*” e cila konvertohet me 63mm, ena e zgjerimit 25 litra, kapacitetin 400V), pra mosparaqitja e tyre në katalog, Komisioni sqaron, se në hartimin dhe përmbushjen e këtij kriteri, autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme paraqitjen edhe të elementeve plotësuese të Pajisjes nr. 9, Grupit të furnizimit me ujë sanitar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje të operatorit ekonomik, se ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesave mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, parashikuar nga neni 110 pika 1 e LPP. Konkretisht në nenin 110, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Rezulton se ankimuesi është njohur me dokumentet e tenderit në datën e publikimit të njoftimit të kontratës dhe afatet e ankimit për dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi për ankimuesin, nisur nga dita e publikimit të tyre dhe mbarojnë në ditën e shtatë sipas parashikimit ligjor në nenin 110, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Operatori ekonomik është palë e interesuar në përmbushje të të gjitha kërkesave të DST, me qëllim fitimin e kontratës, ndaj ofertimi i mallrave në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim është i rëndësishëm. KPP thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Komisioni gjykon, se bazuar në dokumentacionin e dosjes administrative, është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë operatorët ekonomikë i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, Komisioni iu drejtua operatorit ekonomik “INERTI” SHPK, si dhe autoritetit kontraktor, konkretisht ekspertëve të fushës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi mënyrën e përmbushjes së këtij kriteri, për pajisjet nr. 12 Nr. Dhe Nr. 13 Njesi Rekuperatore Ajri.

4.- Pyetje drejtuar operatorit ekonomik “INERTI” SHPK: “Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj si subjekt ankimues, konkretisht:

- **Për pajisjen Nr. 12 dhe Nr. 13 është kërkuar Njesi Rekuperatore Ajri të na tregoni se, në cilën faqe të katalogëve respektivë të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (INERTI_AUTORIZIME_MJEKSIA), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?**

Përgjigjja e OE: *Për njësinë e jashte kujt gradacioni i referoheni?*

Pyetje drejtuar autoritetit kontraktor: *“Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj, mbi vlerësimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për përmbushjen e specifikimit teknik të kërkuar në dokumentet e tenderit, për artikullin me nr. 12 Njesi Rekuperatore Ajri?”*

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): *“Nuk është i qartë asnjë nga specifikimet teknike të paraqitura në katalogë për këto pajisje. Nuk është përcaktuar se cila pajisje është UTH 3 dhe UTH 4.”*

Në lidhje me pretendim e ankimuesit, për arsyen e skualifikimit për pajisjet nr. 12 dhe nr. 13, ku në katalog janë paraqitur variante dhe nuk është markuar modeli të cilit i referohet operatori, Komisioni sqaron, se në seksionin 2 “Objekti i Kontratës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.15 Pranohen variantet:

Po



Jo

X

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, që specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e

kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj" në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 "Për prokurimin publik" KE, parashikohet se: "Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim". Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 "Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës" inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: "Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese." KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në

nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Pra KPP thekson, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se nuk do të pranohen variantet. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik ka detyrimin të dorëzojë në cilësinë e pajisjes vetëm një model/variant sipas specifikimeve/karakteristikave të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Në kuptim dhe në zbatim të parimit të barazisë në trajtimin e kandidatëve/ofertuesve, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit duhet të tregojë kujdes që të përcaktojë të njëjtat të drejta dhe detyrime në radhët e pjesëmarrësve. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e një modeli/varianti sipas specifikimeve/karakteristikave nuk krijon konfuzion tek ofertuesit në plotësimin e kërkesës: KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, ndërsa ofertat që nuk përputhen në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në lidhje me pretendimin e dytë të ankimuesit, mbi vështirësinë e të kuptuarit të specifikimeve, Komisioni sqaron, se nëse autoriteti kontraktor do të kishte paqartësi në vlerësimin për përmbushjen e këtij kriteri dhe në të kuptuarit të specifikimeve teknike të pajisjeve nr. 12 dhe nr. 13, në kuptim të pikës 1, të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve, si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Për sa më sipër, bazuar në faktet dhe informacionin e depozituar në Komisionin e Prokurimit, si dhe në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 05.04.2024 në mjediset e KPP-së, me përfaqësues ekspert fushe të operatorit ekonomik, “INERTI” SHPK, si dhe përfaqësues ekspert fushe, anëtar i njësisë së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nga ana e autoritetit kontraktor, i cili ka qenë pjesë e grupit të punës të ngritur për vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, rezulton, se në përfundim të këtij seksioni në lidhje me sa u deklarua më lart, përfaqësuesi i autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesi i subjektit “INERTI” SHPK, u sqaruan në mënyrë shteruese mbi paqartësitë dhe u saktësuan mbi përmbushjen e specifikimeve teknike për artikujt e sipërcituar. Në fund të seancës dëgjimore, Komisioni iu drejtua palëve të pranishme, nëse kishin pretendime apo kërkesa dhe nuk kishte.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “INERTI” SHPK qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar, për operatorin ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK, për procedurën e prokurimit *Procedurë e Hapur* me nr. **REF- 91765-12-20-2023**, me objekt: “**Rikonstruksioni i godines se anatomisë**”, me fond limit 80,128,758.52 (tetëdhjetë milion e njëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë presje pesëdhjetë e dy) lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 16.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë dhe autoriteti kontraktor të pasqyrojë arsyet e skualifikimit sipas vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK, për procedurën e prokurimit.
3. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar, për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, për procedurën e prokurimit.
4. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, për procedurën e prokurimit.
5. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
6. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar, për operatorin ekonomik “INERTI” SHPK, për procedurën e prokurimit.
7. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INERTI” SHPK për procedurën e prokurimit.
8. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “INERTI” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
9. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
10. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” SHPK.

11. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK.
 12. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INERTI” SHPK.
 13. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 14. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

